



STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**SHKAQET QË MERREN PARASYSH PËR SHKURORËZIMIN E
MARTESËS NË LEGJISLACIONIN POZITIV TË REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Mentor:

Prof. Arta Selmani

Kandidati:

Valon Izairi

Tetovë, 2020

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se përmbajtja e temës së magistraturës së paraqitur është punë origjinale e shkruar prej meje, e cila nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Të gjitha referencat dhe citimet në tekst janë bërë në bazë të burimeve të paraqitur në fusnota.

Me respekt

Valon Izairi

()

STRUKTURIMI I PUNIMIT

STRUKTURIMI I PUNIMIT	3
HYRJE	9
HIPOTEZAT E HULUMTIMIT.....	11
KAPITULLI I PARË.....	12
MARTESA	12
1. Kuptimi i martesës.....	12
2. Objekti i martesës.....	12
3. Subjektet e martesës	12
4. Natyra juridike e martesës	13
5. Qëllimet e martesës.....	13
6. Kushtet themelore për lidhjen e martesës.....	14
a) Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm.....	14
c) Lidhja e martesës përpara organit kompetent	15
7. Pengesat martesore.....	15
a) Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme.....	16
b) Pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme	16
c) Pengesat martesore absolute dhe relative	17
a) Martesa ekzistuese	17
b) Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të gjykuar	17
c) Mungesa e vullnetit.....	18
d) Gjinia.....	20

e) Mituria	21
8. Procedura e dhënies së lejes për lidhjen e martesës	21
KAPITULLI I DYTË	23
KUSHTET FORMALE PËR LIDHJEN E MARTESËS	23
Kushtet formale për lidhjen e martesës	23
a) Forma e lidhjes së martesës	23
b) Procedura paraprake (fejesa)	23
c) Procedura e lidhjes së martesës	24
KAPITULLI I TRETË	26
PUSHIMI I MARTESËS	26
1. Vdekja e njërit prej bashkëshortëve	26
2. Shpallja e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur	26
3. Anulimi i martesës	28
4. Shkurorëzimi i martesës	28
4.1. Sistemet juridike të shkurorëzimit	31
a) Sistemi juridik që ndalon shkurorëzimin	31
b) Sistemi juridik që e lejon shkurorëzimin	31
c) Sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion	32
d) Sistemi i shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi	32
e) Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës	33
4.2. Elementet e shkurorëzimit	34
a) Ekzistimi i martesës së vlefshme	34

b)	Shkurorëzimi bëhet sa të jenë të gjallë bashkëshortët.....	34
c)	Shkurorëzimi bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara me ligj	34
d)	Shkurorëzimi bëhet në procedurë gjyqësore	35
KAPITULLI I KATËRT		36
SHKAQET PËR SHKURORËZIMIN E MARTESËS.....		36
a)	Çrregullimi i marrëdhënieve bashkëshortore.....	36
b)	Tradhtia.....	37
c)	Dhuna, fyerjet e rënda dhe sjellja e keqe	38
d)	Sëmundjet e rënda dhe paaftësia për të vepruar.....	39
e)	Braktisja e paarsyeshme e bashkësisë martesore	39
f)	Zhdukja e njërit nga bashkëshortët	40
g)	Dënimi me burgim i njërit nga bashkëshortët.....	40
h)	Pushimi faktik i martesës	40
i)	Shkurorëzimi me marrëveshje	41
1.	Klasifikimi i shkaqeve të shkurorëzimit	42
a)	Shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta	42
b)	Shkaqe absolute dhe relative	42
c)	Shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me afat.....	43
d)	Shkaqet për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit	43
e)	Shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta të shkurorëzimit të martesës.....	43
2.	Pasqyra historike e shkaqeve të shkurorëzimit në të drejtën romake	45

3. Pasqyra historike e shkaqeve të shkurorëzimit në të drejtën zakonore shqiptare	48
a) Nderi	49
b) Vjedhja	49
c) Virgjëria	49
d) Shkaqe të tjera për shkurorëzimin e martesës	49
KAPITULLI I PESTË	50
PROCEDURA PËR SHKURORËZIMIN E MARTESËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	50
1. Objekti i procedurës për shkurorëzimin e martesës	50
2. Parimet e procedurës së shkurorëzimit	50
a) Parimi i barabarësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit	50
b) Parimi i mbrojtjes së veçantë	51
c) Parimi i oficalitetit	51
d) Parimi i dispozicionit	51
e) Parimi i përjashtimit të publikut	51
3. Kompetenca vendore e gjykatës	52
4. Inicimi i procedurës	52
5. Kumulimi i kërkesave dhe bashkimi i procedurave	53
6. Kufizimi i dispozicionit të palëve	54
7. Procedura për pajtimin e bashkëshortëve	56
8. Procedura pas pajtimit të pasuksesshëm	57
9. Parimi i shqyrtimit dhe hetimit	58
10. Masat e përkohshme	59

11.	Vendimet në procedurën për shkurorëzimin e martesës	59
12.	Mjetet juridike	60
13.	Pasojat e shkurorëzimit të martesës	61
a)	Gjendja statusore	61
b)	Mbiemri	62
c)	Pronësia e përbashkët	62
d)	Mbajtja (ushqimi)	62
e)	E drejta për trashëgim	62
f)	Kthimi i dhuratave	63
g)	Dëmshpërblimi	63
h)	Shpenzimet në procedurë	63
14.	Pasojat e shkurorëzimit të martesës për fëmijët	64
KAPITULLI I GJASHTË		65
ASPEKTI KRAHASUES I PROCEDURAVE PËR SHKAQET E SHKURORËZIMIT TË MARTESËS		65
1.	Shkaqet e shkurorëzimit në Republikën e Kosovës	65
1.1.	Ligji për familje në Republikën e Kosovës	65
1.2.	Krahasimi në mes ligjit për familje në Republikën e Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë në lidhje me shkaqet e shkurorëzimit	66
2.	Shkaqet e shkurorëzimit në Republikën e Shqipërisë	66
2.1.	Kodi për familje në Republikën e Shqipërisë	66
2.2.	Krahasimi në mes të Kodit për familje në Republikën e Shqipërisë dhe të ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë në lidhje me shkaqet e shkurorëzimit	67
KAPITULLI I SHTATË		68

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIME	68
BIBLIOGRAFIA	71

HYRJE

Gjatë jetës martesore, bashkëshortët mund të hasin në vështirësi nga më të ndryshmet. Mes tyre mund të lindin mosmarrëveshje të cilat mund të bëhen shkak që ato të shkurorëzohen.

Shkurorëzimi i martesës mund të bëhet vetëm në qoftë se bashkëshortët kanë lidhur martesë të vlefshme, pasi në të kundërtën deklarohet vetëm pavlefshmëria ose nuliteti i saj. Gjithashtu, vlen të theksohet se shkurorëzimi i martesës bëhet vetëm atëherë kur që të dy bashkëshortët janë gjallë.

Sipas ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë thuhet se martesa mund të shkurorëzohet me marrëveshje të ndërsjellë të bashkëshortëve. Mirëpo ekzistojnë shkaqe nga më të ndryshmet ku vjen në shprehje shkurorëzimi nga vullneti i njëanshëm, kur kemi të bëjmë me jetën e padurueshme martesore, me vepra penale, e shumë shkaqe të tjera të cilat do t'i shqyrtojmë në vazhdim.

Gjatë këtij studimi do të përpiqem që të shpjegoj rëndësinë e të drejtës martesore si dhe rëndësinë e shkaqeve të cilat merren parasysh për shkurorëzimin e martesës, si dhe do të analizoj normat ligjore të shkaqeve të shkurorëzimit të martesës në të drejtën familjare. Do të shpjegoj për faktin se kush mund të lidh martesë, të drejtat dhe detyrat bashkëshortëve, kur mund të vijë deri tek shkurorëzimi i martesës, cilat janë shkaqet që merren parasysh për shkurorëzimin e martesës, në qoftë se bashkëshortët kanë fëmijë si do të ndikojë shkurorëzimi i martesës tek fëmijët, kush do të kujdeset për fëmijët, etj.

Do të analizoj dhe studioj nocionet e së drejtës familjare, siç janë: e drejta martesore, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, si dhe kujdes më të veçantë do ti kushtojë shkaqeve të cilat merren parasysh për shkurorëzimin e martesës si dhe procedurave për shkurorëzimin e martesës.

Vendosa të hulumtoj për këtë institut pasi ka rëndësi të dyfishtë, si teorike ashtu edhe praktike. Prandaj do të analizoj normat në sistemin tonë juridik dhe duke i analizuar edhe ato komparative do të vlerësoj në qoftë se këto norma duhet plotësuar.

HIPOTEZAT E HULUMTIMIT

1. Cilat janë shkaqet nga të cilat vjen deri tek shkurorëzimi i martesës?
2. A janë të mjaftueshme dispozitat ligjore që rregullojnë shkaqet të cilat merren parasysh për shkurorëzimin e martesës dhe a duhet të bëhen ndryshime në dispozitat ligjore në fuqi?

KAPITULLI I PARË

MARTESA

1. Kuptimi i martesës

Sipas ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 6 martesa përkufizohet si: “Martesa është bashkësi jetësore e rregulluar me ligj e një burri dhe një gruaje në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve themelohen në bazë të vendimit të lire të burrit dhe gruas për të lidhur martesën, në bazë të barazisë së tyre, respektit reciprok dhe ndihmës së ndërsjellë”.

Pra, martesë llogaritet ajo bashkësi jetësore e cila i plotëson kushtet materiale dhe formale për lidhjen e saj, të cilat janë caktuar me ligj. Në qoftë se ato kushte nuk plotësohen martesa nuk ekziston.¹

2. Objekti i martesës

Objekti i martesës paraqet tërësinë e normave juridike me të cilat rregullohet lidhja e martesës, ku përfshihen kushtet, forma dhe procedura e lidhjes së martesës, marrëdhëniet mes bashkëshortëve, si ato personale ashtu edhe ato pronësore, si dhe mbarimi i martesës, ku përfshihet mënyra, kushtet si dhe pasojat e mbarimit të martesës.²

Kohën e fundit e drejta martesore gjithashtu rregullon dhe studion edhe bashkësinë jashtëmartesore si dhe marrëdhëniet që lindin në atë bashkësi.³

3. Subjektet e martesës

Neni 15 ne ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut thotë: “Martesë mund të lidhin dy persona me gjini të kundërt, me deklaratë të lirë të vullnetit, përpara organit kompetent, në mënyrë të përcaktuar me ligj.”

¹ Cavdar Kiril, Silanoska Kostadinovska Cvetanka, Komentar na zakonot za semejstvoto, 2013 Shkup, faqe 34

² Spiroviq-Tërpenovska Liljana, Semejno pravo, 1997 Shkup, faqe 63

³ Gani Oruci, E drejta familjare, 1994 Prishtine, faqe 34

Pra, siç e parasheh ligji në Republikën e Maqedonisë së Veriut, martesë mund të lidhin vetëm personat me gjini të kundërt, burri dhe gruaja. Nuk lejohet martesë mes personave të së njëjtës gjini.

4. Natyra juridike e martesës

Ekzistojnë pikëpamje të ndryshme sa i përket natyrës juridike të martesës, edhe atë:

- a) Sipas njërës pikëpamje martesë është kontratë civile. Kjo pikëpamje tregon mënyrën e themelimit të martesës;
- b) Sipas pikëpamjes së dytë, martesë është institucion juridik apo shoqëror. Kjo pikëpamje tregon gjendjen që krijohet me themelimin e martesës;
- c) Sipas pikëpamjes së tretë, martesë nuk konsiderohet as vetëm si kontratë e as vetëm si institucion juridik, por, për nga mënyra e themelimit konsiderohet si kontratë e llojit të veçantë, ndërsa për nga përmbajtja si institucion juridik.⁴

5. Qëllimet e martesës

Nga vetë përmbajtja e martesës dalin edhe qëllimet martesore, ku si më të rëndësishme janë: *a) qëllimi natyror; b) qëllimi moral; si dhe c) qëllimi shoqëror.*

a) Qëllimi natyror ka të bëjë me marrëdhëniet intime mes bashkëshortëve, me lindjen e fëmijëve dhe mirërritjen e tyre. Ky qëllim ka edhe rëndësi shoqërore, pasi lindja e fëmijëve ndihmon përtëritjen e shoqërisë njerëzore.

b) Qëllimi moral ka të bëjë me ndihmën që bashkëshortët i japin njëri tjetrit. Ajo mund të jetë ndihmë materiale ose morale. Ndihma në martesë është si e natyrshme ashtu edhe e domosdoshme për realizimin e funksioneve të ndryshme në martesë.

c) Qëllimi shoqëror ka të bëjë me faktin se martesë është bazë e familjes, ndërsa familja është bazë e shoqërisë. Pra, në martesë pos interesave të bashkëshortëve realizohen edhe interesat e shoqërisë, andaj shoqëria me instrumente juridike dhe me instrumente të tjera ka për detyrë të krijojë kushte të nevojshme për martesë të shëndoshë.⁵

⁴ Oruçi Gani, E drejta familjare, 1994 Prishtinë, faqe 39

⁵ Po aty, faqe 40

6. Kushtet themelore për lidhjen e martesës

Martesa themelohet nën kushte të parashikuara me ligj. Si në legjislacionin tonë pozitiv, ashtu edhe në shumicën e legjislacioneve kërkohet plotësimi i disa kushteve të caktuara për lidhjen e martesës, të cilat kushte ndahen në: a) kushte materiale për lidhjen e martesës; si dhe b) kushte formale për lidhjen e martesës.⁶

Sipas disa teorive, kushte thelbësore për lidhjen e martesës janë:

-vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm;

-sekset e kundërta;

-lidhja e martesës përpara organit kompetent.⁷

a) Vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm është njëri ndër kushtet kryesore për lidhjen e martesës së vlefshme, ku bashkëshortët e ardhshëm deklarojnë se martesën e lidhin me vullnetin e tyre të lirë dhe se nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa martesore. Martesa nuk do të konsiderohet si e vlefshme në qoftë se bashkëshortët nuk kanë deklaruar me vullnetin e tyre të lirë por me kërcënim, shtrëngim, lajthim apo në ndonjë mënyrë tjetër.⁸

b) Sekset e kundërta përbëjnë komponentin biologjik, kulturor dhe civilizues të një martese. Historikisht, martesa ka qenë privilegj i dy personave me gjini të kundërta, pra i burrit dhe gruas. Si qëllim kryesor i martesës ka qenë dhe vazhdon të jetë lindja dhe mirërritja e fëmijëve, si dhe kryerja e marrëdhënieve seksuale. Martesa mes personave me gjini të njëjta nuk lejohet, si në vendin tonë ashtu edhe në rregullativat e shumë shteteve të tjera. Prandaj, mungesa e sekseve të njëjta paraqet pengesën absolute për lidhjen e martesës.⁹

Edhe ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 15, sa i përket gjinisë thotë: “Martesë mund të lidhin dy persona me gjini të kundërt me deklaratë të lirë të vullnetit përpara organit kompetent, në mënyrë të caktuar me ligj”.

Jo në të gjitha shtetet vlen ky ligj, pra si kusht për lidhjen e martesës jo në të gjitha shtetet është gjinia e kundërt e bashkëshortëve.

⁶ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, E drejta familjare, 2007 Prishtinë, faqe 91

⁷ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, 2005 Prishtinë, faqe 72

⁸ Po aty, faqe 72

⁹ Po aty, faqe 73

Si shembull kemi Republikën e Kosovës ku lejohet martesë edhe mes bashkëshortëve me gjini të njëjtë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 37 thotë: “Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.”

c) Lidhja e martesës përpara organit kompetent është kusht kryesor pasi martesë lidhet përpara organit kompetent, pra, përpara organit të gjendjes -civile. Bashkëshortët deklarohen për vullnetin e lirë për lidhjen e martesës e shprehin para organit kompetent. Në të kundërtën martesë nuk është e vlefshme pasi nuk plotësohet kushti thelbësor i parashikuar me ligj. Martesë lidhet në formë solemne (forma ad solemnitatem) dhe në hapësirat e caktuara për lidhjen e saj. Gjatë lidhjes së martesës, prezent duhet të jenë të dy bashkëshortët, dy dëshmitarë dhe nëpunësit e gjendjes civile. Në qoftë se nuk plotësohen këto kushte konsiderohet se martesë nuk ka ekzistuar. Martesë që nuk është lidhur në mënyrën e përcaktuar me ligj është nule.¹⁰

7. Pengesat martesore

Pengesat martesore (*impedimenta matrimonii*) janë fakte dhe rrethana të përcaktuara në ligj, ekzistenca e të cilave e pengon martesën. Pengesat martesore nuk duhet të ekzistojnë në momentin e lidhjes së martesës sepse e pengojnë këtë akt dhe shkaktojnë anulimin e saj. Që të krijojnë efekte juridike, pengesat martesore duhet të jenë të parashikuara në dispozitat ligjore. Prandaj, duke e marrë parasysh rëndësinë e tyre, përveç sanksioneve të së drejtës familjare, për disa pengesa martesore ligjvënësi ka përcaktuar edhe sanksione penale juridike.¹¹

Në teori të ndryshme juridike janë parashikuar edhe ndalesat martesore.

Ndalesat janë fakte dhe rrethana të caktuara me ligj, që e ndalojnë lidhjen e martesës përderisa ekzistojnë. Ekzistimi i ndalesave e pengon lidhjen e martesës, mirëpo mosrespektimi i tyre nuk ka pasojë anulimin e martesës, por vetëm përgjegjësinë penale për personat të cilët kanë qenë në dijeni për këto rrethana dhe prapë se prapë e kanë lejuar lidhjen e martesës.¹²

Si ndalesë konsiderohet lidhja e martesës mes kujdestarit dhe të kujdesurit, gjatë kohës së kujdestarisë. Nëse lidhet martesë, marrëdhënia e kujdestarisë do të pushojë, ndërsa martesë do të vazhdojë të mbetet e vlefshme. I njëjti rast është edhe me adoptimin jo të plotë. Disa

¹⁰ Podvorica Hamdi, E drejta familjare, 2005 Prishtinë, faqe 75

¹¹ Po aty, faqe 75

¹² Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 112

legjislacione si ndalesë e llogaritit edhe martesën e të miturit pa lejen e prindit, kujdestarit apo organit kompetent.¹³

Dallimi mes pengesave martesore dhe ndalesave martesore qëndron në faktin se mospërfillja e pengesave shkakton sanksione juridike familjare që kanë të bëjnë me anulimin e martesës, si dhe me sanksione juridike penale që kanë të bëjnë me përgjegjësinë penale të personave pjesëmarrës në lidhjen e martesës, ndërsa mospërfillja e ndalesave martesore shkakton vetëm sanksione juridike penale e jo edhe sanksione juridike familjare.¹⁴

Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk i përfshin ndalesat martesore.

Në teorinë juridike pengesat martesore klasifikohen sipas disa kriterëve: pengesa martesore të evitueshme dhe të paevitueshme; pengesa martesore të përhershme dhe të përkohshme; si dhe pengesa martesore absolute dhe relative.

a) Pengesat martesore të evitueshme dhe të paevitueshme

Të evitueshme janë ato pengesa për të cilat gjykata mund të japë lejen për lidhjen e martesës, por vetëm në raste të parashikuara me ligj. Si pengesa të tilla konsiderohen: mituria dhe gjinia e krushqisë, pasi në raste të justifikuara gjykata mund të lejojë lidhjen e martesës me këto pengesa. Ndërsa, të paevitueshme janë pengesat për të cilat gjykata nuk mund të japë leje për lidhjen e martesës. Të tilla konsiderohen: mungesa e vullnetit, martesa ekzistuese, sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, si dhe gjinia e gjakut.¹⁵

Për gjininë e krushqisë, për shkaqe të arsyeshme gjykata mund të lejojë lidhjen e martesës. Si shkak për lidhjen e martesës mes personave në gjini të krushqisë mund të jetë edhe lindja e fëmijëve në mes këtyre personave. Ligjvënësi nuk i ka përmendur rastet e tilla, por gjykata i shqyrton të gjitha rastet veç e veç.¹⁶

b) Pengesat martesore të përhershme dhe të përkohshme

Të përhershme janë pengesat që nuk pushojnë së ekzistuari edhe me kalimin e kohës, deri në vdekje. Pengesë e tillë është: gjinia e gjakut. Ndërsa pengesa martesore të përkohshme janë pengesat të cilat me kalimin e kohës mund të pushojnë së ekzistuari, ato janë: mungesa e vullnetit, martesa ekzistuese, sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, si dhe mituria.¹⁷

¹³ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 90

¹⁴ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 50

¹⁵ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 75

¹⁶ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, E drejta familjare, 2007 Prishtinë, faqe 108

¹⁷ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 76

c) Pengesat martesore absolute dhe relative

Absolute janë pengesat martesore që pamundësojnë lidhjen e martesës me cilindo person. Këto pengesa veprojnë mbi të gjithë personat, pra janë *erga omnes*. Të tilla janë: sëmundjet psikike dhe pazotësia për të vepruar, mituria deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, si dhe ekzistimi i martesës. Ndërsa, relative janë pengesat martesore që pamundësojnë lidhjen e martesës vetëm me personat e caktuar (gjini krushqie). Pra, pengesat e tilla veprojnë vetëm mbi personat e caktuar *inter partes*.¹⁸

Në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë si pengesa martesore janë parashikuar: martesa ekzistuese, sëmundjet psikike, mungesa e vullnetit, gjinia, si dhe mituria.

a) Martesa ekzistuese

Sa i përket martesës ekzistuese, ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 17 thotë: “Nuk mund të lidhë martesë personi, përderisa martesa e mëparshme nuk i ka pushuar”.

Pra, martesa ekzistuese është pengesë martesore atëherë kur një person lidh martesën e dytë pa e shkëputur martesën e parë. Askush nuk mund të lidhë martesë të re përderisa martesa e parë nuk pushon juridikisht. Në të kundërtën, martesa e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit bashkëshort do të jetë *nule*. Gjatë lidhjes së martesës, nëpunësi i gjendjes civile është i obliguar të vërtetojë dhe të konstatojë se nuk ekziston ndonjë martesë e ligjshme, e kjo vërtetohet me certifikatën e martesës.¹⁹

Poligamia nuk është e lejuar në të drejtën familjare, ndërsa bigamia është e inkriminuar si vepër penale. Një person mund të lidh dy apo më tepër martesa, mirëpo vetëm një pas një, suksesivisht, pasi të ketë pushuar martesa e mëparshme.²⁰

b) Sëmundjet psikike dhe paaftësia për të gjykuar

Nuk mund të lidhin martesë personat me sëmundje psikike ose me zhvillim të metë mendor dhe personat pa zotësi veprimi, pasi që janë të paaftë të kuptojnë qëllimin e martesës. Arsye të ekzistimit të kësaj pengese janë fakti që nuk ekziston shprehja e vullnetit në mënyrë relevante juridike, sepse personat me shëndet mental të metë nuk janë të vetëdijshëm dhe nuk mund ta kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta. Si dhe arsye tjetër është ajo se sipas disa analizave të bëra, 16 për qind e fëmijëve të sëmurë skizofrenia kanë trashëguar sëmundjen nga

¹⁸ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 76

¹⁹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 103

²⁰ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 45

prindërit, e kjo do të ishte shkak për degjenerimin e popullsisë dhe barrë e shoqërisë për t'u kujdesur dhe për t'i shëruar personat e tillë.²¹

Pra, sëmundja psikike është një nga shkaqet që ka si pasojë paaftësinë për të gjykuar, pasi ka edhe shkaqe tjera, si marrëzia, alkoolizmi, përdorimi i mjeteve narkotike, lëndimet e trurit, etj. Do të thotë se, personi që është i sëmurë psikik ose i paaftë për të gjykuar, nuk mund të lidhë martesë pasi nuk është në gjendje që të kryejë disa nga detyrat martesore si dhe ekziston edhe rreziku që pasardhësit e tij të trashëgojnë këtë sëmundje.²²

Edhe ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, neni 18, lidhur me martesën e personave me sëmundje psikike thotë: “Nuk mund të lidhin martesë personat të cilët për shkak të formës së manifestuar të sëmundjes psikike me prani të simptomave psihotike ose me shenja reziduale nga sëmundja, nuk janë në gjendje që ta kuptojnë rëndësinë e martesës dhe obligimeve që dalin prej saj dhe të tillët njëkohësisht janë të paaftë për të gjykuar. Nuk mund të lidhin martesë edhe personat me zhvillim të metë mendor (psikik) nëse i takojnë grupit të personave me mbetje mentale të rëndë dhe më të rëndë IQ është nën 36 shkallë”.

Neni 18 po ashtu thotë: “Personat të cilët janë të numëruar si persona me pengesa të zbutura në zhvillim psikik ose me pengesa të lehta në zhvillim psikik si edhe personat të cilët kanë sëmundje trashëguese nga familja, mund të lidhin martesë pas mendimit të marrë lidhur me konstruksionin gjenetik të dhëna nga enti për shëndet mendor të fëmijëve dhe të rinjve në Shkup ose ndonjë institucioni tjetër përkatës që merret me hulumtime gjenetike”.

Sëmundja psikike ose zhvillimi mendor i metë duhet të ekzistojë në çastin e lidhjes së martesës, pra në momentin e deklarimit të vullnetit para nëpunësit të gjendjes civile. Po në këtë rast duhet të ekzistojë edhe pazotësia e veprimit. Në qoftë se do të ekzistojnë këto pengesa në çastin e lidhjes së martesës, martesë nuk do të jetë e vlefshme. Ndërsa, nëse sëmundja psikike ose zhvillimi mendor i metë shfaqet pas lidhjes së martesës, ajo nuk do të përbëjë shkak për pavlefshmërinë e martesës. Në këtë rast mund të kërkohet vetëm zgjidhja e martesës.²³

c) Mungesa e vullnetit

Gjatë lidhjes së martesës është e nevojshme që palët ta shprehin vullnetin e lirë dhe të kenë parasysh të gjitha pasojat juridike që lindin nga lidhja e martesës. Martesa nuk do të jetë e vlefshme në qoftë se deklarata e njërit bashkëshort për lidhjen e martesës është dhënë me dhunë apo në ndonjë formë tjetër jo ligjore. Martesa e lidhur në këto rrethana do të zgjidhet.²⁴

²¹ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 82

²² Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 46

²³ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 83

²⁴ Haxhivasilev Mile, Semejno pravo, 1987 Shkup, faqe 113

Sipas ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë, neni 19: “Martesa nuk do të jetë e plotfuqishme kur pajtimi për lidhjen e martesës është nën ndikimin e dhunës dhe lajthimit”.

Dhuna dhe kanosja në të drejtën familjare ekzistojnë kur vullneti për lidhjen e martesës është deklaruar nga frika e shkaktuar nga kanosja. Pra, personi që deklaron vullnetin për lidhjen e martesës, është i vetëdijshëm për mospërputhjen e vullnetit të deklaruar me vullnetin e brendshëm. Pra, është rezultat i frikës.²⁵

Me dhunë nënkuptojmë kur njëri bashkëshort apo edhe të dy bashkëshortët kanosen që të lidhin martesë kundër vullnetit të tyre. Ndërsa, me lajthim nënkuptojmë kur njëri bashkëshort ka pasur mendim të gabueshëm mbi rrethanat, faktet dhe cilësitë e bashkëshortit tjetër në momentin e lidhjes së martesës, nga të cilat jetesa e përbashkët bëhet e padurueshme. Pra, dhuna dallon nga lajthimi pasi që me dhunë, bashkëshorti është i vetëdijshëm në momentin e lidhjes së martesës për rrethanat dhe kushtet nga të cilat jetën martesore do ta bëjnë të padurueshme, ndërsa me lajthim, në momentin e lidhjes së martesës bashkëshorti nuk i din këto rrethana.²⁶

Dhuna, sipas Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, është e ndaluar. Neni 11 i Kushtetutës thotë: “Integriteti fizik dhe moral i njeriut janë të pacenueshëm. Ndalohet çdo formë e torturës, e sjelljes dhe e dënimit çnjerëzor dhe poshtërues. Ndalohet puna me dhunë.”

Dhuna mund të jetë e natyrës psikologjike dhe fizike. Me kanosje kuptohet vetëm ushtrimi i dhunës psikologjike, e cila kufizohet me paralajmërimet frikësuese serioze, që kërcënuesi ia drejton personit të caktuar se ndaj tij do të ushtrohet së shpejti dhuna fizike ose do t’i shkaktohet një e keqe tjetër nëse nuk lidh martesë me personin e caktuar. Dhuna fizike dallon nga ajo psikologjike, pasi tek dhuna fizike kanosja fillon të ekzekutohet. Raste tipike janë mbajtja me forcë me rastin e firmosjes së deklaratës.²⁷

Lajthimi ekziston kur vullneti i deklaruar nuk përputhet me vullnetin e vërtetë të personit që lidh martesë, për shkak se nuk është në dijeni për faktet apo rrethanat të cilat po t’i dinte nuk do të deklaronte vullnetin për lidhjen e martesës me personin e caktuar. Pra, i lajthituri nuk është në vetëdije për shpërputhjen e vullnetit të deklaruar me vullnetin e brendshëm. Edhe lajthimi duhet të jetë serioz, si dhe personi i lajthitur nuk duhet të jetë i vetëdijshëm për lajthim. Lidhja e martesës nën ndikimin e lajthimit është fakt për të kërkuar anulimin e saj.²⁸

²⁵ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 44

²⁶ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 77

²⁷ Po aty, faqe 77

²⁸ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 98

d) Gjinia

Gjinia e gjakut është përcaktuar me dispozita ligjore si pengesë martesore. Ekzistojnë tre lloje të gjinisë si pengesë martesore: gjinia e gjaku, gjinia e adoptimit dhe gjinia e krushqisë.²⁹

Neni 20 i ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë sa i përket gjinisë së gjakut si pengesë tek lidhja e martesës, thotë: “Nuk mund të lidhin martesë ndërmjet tyre të afërmit e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë (gjyshi, gjyshja, nëna, babai dhe nipërit), si edhe as vëllezërit dhe motrat e lindur, vëllai dhe motra nga babai, gjegjësisht nga nëna, xhaxhai dhe fëmija i vëllait, daja dhe fëmija nga motra, teza dhe fëmija nga vëllai, teza dhe fëmija nga motra, as kushërinjtë e parë”.

Gjinia e gjakut është pengesë absolute martesore sepse ajo krijohet një herë me martesë ose bashkësi jashtëmartesore dhe vazhdon të ekzistojë çdoherë. Prandaj, personat që ndodhen në gjininë e gjakut të përcaktuar me ligj si pengesë martesore, nuk mund të lidhin martesë. Nëpunësi i gjendjes civile duhet të refuzojë kërkesën për lidhjen e martesës mes personave në gjini të gjakut. Lidhja e martesës me personat në gjini të gjakut është shkak për të kërkuar anulimin e martesës. Gjinia e gjakut është pengesë për lidhjen e martesës për shkaqe morale si dhe për shkaqe eugjenike. Qëllimi i saj është që të pengoj lidhjen e martesave të tilla për të penguar lidhjen e fëmijëve me të meta psikike dhe fizike, si dhe për ruajtjen e raporteve morale mes anëtarëve të familjes.³⁰

Edhe gjinia e adoptimit është pengesë martesore e cila e shkakton anulimin e martesës njësoj sikur edhe gjinia e gjakut, pra sjell deri tek pavlefshmëria absolute e martesës. Adoptimi është pengesë martesore në vijë të drejtë pa kufi, ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt. Arsyet e adoptimit si pengesë martesore rrjedhin nga fakti se me adoptim krijohen marrëdhënie të njëjta sikur të marrëdhëniet prindërore.³¹

Sa i përket gjinisë së krushqisë si pengesë martesore, ligji për familje i Republikës së Maqedonisë thotë: “Nuk mund të lidhin martesë vjehrrin dhe nusja, dhëndri dhe vjehrra, njerku dhe thjeshtira, njerka dhe thjeshtiri, pa marrë parasysh nëse lidhja martesore me të cilën kanë ardhur në këtë lidhje familjare ka përfunduar. Për shkaqe të arsyeshme gjyqi kompetent mundet në procedurë jashtë kontestimore të lejojë që të afërmit e këtij neni midis veti të lidhin martesë”.

Gjinia e krushqisë është pengesë martese për shkaqe morale, që të ruhet respekti mes personave të afërm në gjini, pra mes njërit bashkëshort dhe të afërmeve të tij.³²

²⁹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 106

³⁰ Po aty, faqe 107

³¹ Po aty, faqe 108

³² Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 47

Ligji për familje në Republikën e Maqedonisë si pengesë martesore konsideron edhe gjininë jashtëmartesore, ku në nenin 22 shprehet: “Gjinia jashtëmartesore paraqet pengesë për lidhjen e martesës ashtu sikurse edhe gjinia martesore”.

e) Mituria

Pasi që personat e mitur para moshës 18 vjeçare nuk mund ta fitojnë zotësinë për të vepruar, ato nuk mund të lidhin martesë, sepse lidhja e martesës është lidhje e një kontrate në të drejtën familjare dhe personat pa zotësi të veprimit nuk mund ta lidhin atë.³³

Për miturinë si pengesë martesore ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut në nenin 16 thotë: “Nuk mund të lidhë martesë personi i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeçare. Gjykata kompetente ka mundësi që në procedurë jokontestimore t’i lejojë lidhjen e martesës personit i cili nuk ka mbushur moshën 18 vjeçare nëse vërteton se ai ka arritur pjekurinë fizike dhe psikike të nevojshme për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që krijohen në martesë dhe pas sigurimit të mendimit të institucionit shëndetësorë dhe ndihmës profesionale të ofruar nga Qendra për punë sociale”.

8. Procedura e dhënies së lejes për lidhjen e martesës

Në procedurën për dhënien e lejes për lidhjen e martesës, gjykata do të vendos për dhënien e lejes për lidhjen e martesës mes personave, për të cilët ekzistojnë pengesat martesore. Këtë procedurë e inicon personi i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuar me ligj për lidhjen e martesës, si p.sh. kur nuk e ka arritur moshën madhore, etj. Ndërsa në rastet kur të dy personat që dëshirojnë të lidhin martesë nuk i plotësojnë kushtet ligjore, atëherë procedura do të iniciohet me propozimin e të dyve. Në vendimin me të cilin pranohet propozimi për lidhjen e martesës, do të shënohen emrat e personave që duan të lidhin martesë.³⁴

Sipas nenit 94 të ligjit për procedurë jashtëkontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sa i përket martesës së personit të mitur: “Gjyqi është i obliguar që t’i analizojë të gjitha rrethanat thelbësore për vendimmarrje, e veçanërisht të konfirmojë nëse personi i mitur e ka arritur pjekurinë trupore psikike për kryerjen e të drejtave dhe obligimeve që vijnë në martesë dhe nëse lirisht dhe me arsye ka marrë vendim që të lidhë martesë. Gjyqi është i obliguar që t’i analizojë edhe cilësitë personale, gjendjen pronësore dhe rrethanat e tjera thelbësore, që kanë të bëjnë me personin me të cilin i mituri dëshiron të lidhë martesë. Për

³³ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 86

³⁴ Brestovci Faik, E drejta procedural civile II, 1997 Prishtinë, faqe 131

analizën, përkatësisht konfirmimin e rrethanave nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, gjyqi do t'i dëgjojë të miturin, prindërit e tij, përkatësisht tutorin, personin me të cilin i mituri dëshiron të lidhë martesën, pas mendimit të marrë paraprakisht nga institucioni shëndetësor dhe ndihmës profesionale nga qendra për punë sociale. Dëgjimi i të miturit kryhet veç, pa praninë e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë”.

Neni 99 i ligjit për procedurë jashtëkontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me aktvendimin me të cilin lejohet lidhja e martesës thotë: “Në aktvendimin me të cilin personit të mitur i lejohet lidhja e martesës, shënohet me cilin person i lejohet ta lidhë martesën, si dhe ajo se martesa mund të lidhet pas plotfuqishmërisë së aktvendimit. Në arsyetimin e aktvendimit me të cilin jepet leja për lidhjen e martesës, gjyqi i shënon faktet dhe rrethanat në bazë të të cilave ka përfunduar se ekziston pjekuria trupore dhe psikike e të miturit, e duhur për kryerjen e të drejtave dhe detyrave që vijnë në martesë”.

Të njëjtat dispozita vlejnë edhe në procedurën për dhënien e lejes për lidhjen e martesës ndërmjet personave që janë të lindur (farefis).

KAPITULLI I DYTË

KUSHTET FORMALE PËR LIDHJEN E MARTESËS

Kushtet formale për lidhjen e martesës

Kushtet formale për lidhjen e martesës janë: a) forma e lidhjes së martesës; b) procedura paraprake (fejesa); c) Procedura e lidhjes së martesës.

a) Forma e lidhjes së martesës

Forma e lidhjes së martesës është civile, që do të thotë se martesa lidhet përpara organeve kompetente shtetërore apo thënë ndryshe, përpara nëpunësit të gjendjes civile, si dhe ajo lidhet sipas dispozitave ligjore.

Forma civile e martesës është formë e detyrueshme e cila e bën martesën të vlefshme. Martesa e cila nuk do të lidhet në formën civile nuk do të jetë e plotfuqishme. Megjithatë, ligdhënësi e lejon edhe formën fetare (religjioze) të martesës, e cila mund të bëhet pasi të jetë lidhur martesa në formën civile.³⁵

b) Procedura paraprake (fejesa)

Fejesa (Sponsalia) është premtim reciprok, joformal i dy personave me gjini të kundërt se në të ardhmen do të lidhin martesë. Pasi që është joformale, fejesa nuk prodhon efekte juridike, pra nuk ka për pasojë detyrimin e lidhjes së martesës edhe pse qëllimi i saj ka qenë lidhja e martesës.³⁶

Megjithatë, fejesa prodhon efekte juridike mes të fejuarve, si: kompensimin e demit në rast të shkëputjes së fejesës, si dhe kthimin e dhuratave. Nëse personi i fejuar heq dorë nga fejesa, ai është i detyruar që të paguaj çdo dëm që i ka shkaktuar të fejuarit tjetër. Gjithashtu, në rastet kur fejesa nuk përfundon me martesë, secili i fejuar mund të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave të cilat i ka dhënë me rastin e fejesës. Kthimi i dhuratave bëhet sipas rregullave të pasurimit pa bazë.³⁷

Fejesa pushon me lidhjen e martesës, me shkëputje në bazë të marrëveshjes, me shkëputje të njëanshme, si dhe me vdekje.³⁸

³⁵ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 116

³⁶ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 51

³⁷ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 89

³⁸ Po aty, faqe 90

Në të drejtën romake, para martesës lidhej fejesa, pra dhënia dhe marrja reciproke e premtimeve për lidhjen e martesës: *sponsalia sunt mentio et repromissio nuptiarum futurarum*. Forma e lidhjes së fejesës ishte *sponsio* solemne mes prindërve të bashkëshortëve të ardhshëm, ku *paterfamilias* (babai) i të fejuarit jepte fjalën që nusen do e pranonte si nuse të të birit. Gjatë ceremonisë së fejesës mund të merrnin pjesë edhe bashkëshortët e ardhshëm, mirëpo prezenca e tyre nuk kishte rëndësi juridike. Me lidhjen e fejesës rezultonte detyrimi që të lidhej martesa e kontraktuar. Më vonë ky detyrim ra poshtë si rezultat i parimit mbi nevojën e lirisë me rastin e lidhjes së martesës (*matrimonia libera esse debent*). Kur njëri nga të fejuarit e prishte fejesën nga ai kërkohej vetëm zhdëmtimi, pra kthimi i dhuratave.³⁹

Fejesa si procedurë paraprake për lidhjen e martesës nuk përfshihet në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që do të thotë se, fejesa nuk prodhon efekte juridike në RMV.

c) Procedura e lidhjes së martesës

Procedura e lidhjes së martesës përfshin të gjitha ato veprime procedurale të bashkëshortëve dhe organit kompetent (ofiqarit) përmes së cilave do të lidhet martesa e plotfuqishme. Kjo procedurë është administrative dhe vlejnë rregullat e saj.⁴⁰

Personat që duan të lidhin martesë fillimisht parashtrojnë fletëparaqitje deri te organi administrativ kompetent për mbajtjen e librave amë të të kurorëzuarve, e cila mund të bëhet me shkrim ose gojarisht. Fletëparaqitjes i bashkëngjiten certifikatat nga libri amë i të lindurve, si dhe dokumente të tjera kur kjo është e nevojshme (aktvendim me të cilin lejohet lidhja e martesës, provë se martesa e mëparshme ka përfunduar, autorizim, etj.).⁴¹

Neni 27 i Ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut thotë: “Martesa lidhet në prani të personave që dëshirojnë të lidhin martesë, anëtarit të këshillit të komunës që do ta përcaktojë ai, dy dëshmitarë dhe ofiqari. Dëshmitarë gjatë lidhjes së martesës mund të jetë secili person me zotësi veprimi.”

Lidhja e martesës fillon me raportin e ofiqarit se janë të pranishëm personat që duan të lidhin martesë dhe se në bazë të dokumenteve, deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm dhe dëshmitarëve, është vërtetuar se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës. Anëtari i këshillit i njofton bashkëshortët për rëndësinë e martesës si dhe për të drejtat dhe obligimet që dalin nga martesa. Pastaj i pyet individualisht bashkëshortët e ardhshëm nëse dakordohen të lidhin martesë. Këtë deklaratë ofiqari do ta regjistrojë në librin amë të të kurorëzuarve ku do të nënshkruajnë edhe bashkëshortët e ardhshëm, anëtari i këshillit komunal, dëshmitarët dhe

³⁹ Puhan Ivo, E drejta romake, 1968 Prishtinë, faqe 182

⁴⁰ Po aty, faqe 117

⁴¹ Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.38/2004, neni 23

ofiqari. Martesa e lidhur do të shënohet në librin amë të të kurorëzuarve, si dhe bashkëshortëve do t'u jepet certifikatë.⁴²

Martesa mund të lidhet edhe në formën fetare (religjioze), mirëpo pasi të jetë lidhur martesa civile. Ligji për familje i republikës së Maqedonisë sa i përket martesës në formën fetare, në nenin 30 thekson: “Martesa e lidhur sipas zakoneve fetare nuk prodhon efekte juridike.”

Martesë gjithashtu mund të lidhin persona me shtetësi të njëjtë si dhe persona me shtetësi të ndryshme. Në këto raste kërkohen dokumente të veçanta për lidhjen e martesës së vlefshme.⁴³

⁴² Neni 29, Ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁴³ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 123

KAPITULLI I TRETË

PUSHIMI I MARTESËS

Ligji për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sa i përket pushimit të martesës, në nenin 34 thotë: “Martesa pushon me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e martesës”.

1. Vdekja e njërit prej bashkëshortëve

Martesa është bashkësi jetësore e vazhdueshme mes burrit dhe gruas *inter vivos*, e cila mbaron me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve. Vdekja është mënyra natyrore e pushimit të martesës.⁴⁴

Vdekja konstatohet nga ekspertët mjeko-ligjorë dhe pastaj regjistrohet në librin amë të të vdekurve, ndërsa provohet me aktvdekjen.⁴⁵

Pushimi i martesës me vdekje prodhon efekte juridike lidhur me çështjet statusore, mbiemrin martesor, trashëgiminë dhe pjesëtimin e pasurisë së përbashkët. Pra, pas pushimit të martesës me vdekje, bashkëshorti tjetër ka të drejtë që menjëherë të lidh martesë të re, ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e mbiemrit në qoftë se ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, ka të drejtë të trashëgojë bashkëshortin në bazë të ligjit dhe të testamentit, si dhe ka të drejtë që të kërkojë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët.⁴⁶

2. Shpallja e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur

Shpallja e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur barazohet me vdekjen. Shpallja e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kushteve të caktuara me ligj.⁴⁷

Ligji për procedurë jashtëkontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nenin 76 thotë: “Në procedurën për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur dhe për vërtetimin e

⁴⁴ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 111

⁴⁵ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 85

⁴⁶ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 147

⁴⁷ Po aty, faqe 148

vdekjes, gjyqi e shpall personin e zhdukur si të vdekur, përkatësisht e konfirmon vdekjen e personit për të cilin nuk ka dëshmi se ka vdekur, sipas kushteve të parapara me ligj.”

Neni 76 i ligjit për procedurë jashtëkontestimore i RMV-së, thotë: “Propozim për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur, mund të paraqesë secili person që ka interes juridik për këtë dhe prokurori publik. Propozim nga paragrafi 1 i këtij neni mund të paraqesë edhe avokati publik, kur është në pyetje interesi pronësor i Republikës”.

Gjykata, pasi të pranojë propozimin për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur, do të vlerësojë në qoftë se ka nevojë për dëgjimin e dëshmitarëve. Pasi që gjykata do të konfirmojë se janë plotësuar kushtet për ngritjen e procedurës, do të japë shpallje ku do të shënohen rrethanat për rastin dhe do të thirret personi i zhdukur ose të gjithë ata që dine për jetën e personit të zhdukur, që të paraqiten në gjykatë në afat prej tre muajsh nga dita e shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pas skadimit të këtij afati, personi i zhdukur do të shpallet si i vdekur.⁴⁸

Ligji për procedurë jashtëkontestimore, në nenin 81, tregon rastet se kur shpallet personi i zhdukur si i vdekur: “Pas skadimit të afatit të përcaktuar në shpallje, gjyqi do të caktojë seancë në të cilën do t’i dëgjojë propozuesin dhe tutorin e personit të zhdukur dhe varësisht nga rezultatet e procedurës, do ta shpallë si të vdekur personin:

1. Për jetën e të cilit në pesë vitet e fundit, nuk ka pasur kurrfarë lajmesh, ndërsa nga lindja e të cilit kanë kaluar së paku gjashtëdhjetë vjet;
2. Për jetën e të cilit në pesë vitet e fundit nuk ka pasur kurrfarë lajmesh, e për të cilin mund të besohet se më nuk është gjallë;
3. Që është zhdukur në anije, fatkeqësi komunikacioni, zjarr, vërshim, tërmet ose në rrezik tjetër të drejtpërdrejtë për vdekje, e për jetën e të cilit nuk ka pasur kurrfarë lajmesh, së paku gjashtë muaj nga dita kur ka pushuar rreziku;
4. Që është zhdukur në kohën e gjendjes së luftës, e për jetën e të cilit nuk ka pasur kurrfarë lajmesh, një vit nga dita kur kanë pushuar armiqësitë”.

Kur flasim për pushimin e martesës me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur, neni 34 i ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut thotë: “Nëse njëri prej bashkëshortëve është shpallur për të vdekur martesa pushon në ditën e cila me aktvendim është përcaktuar si ditë e vdekjes së tij”.

⁴⁸ Neni 78 dhe 79, Ligji për procedurë jashtëkontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut

3. Anulimi i martesës

Neni 35 në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë thotë: “Martesa do të anulohet nëse vërtetohet se gjatë lidhjes së saj ka ekzistuar ndonjëra nga pengesat e parapara të këtij ligji”.

Anulimi i martesës është mënyrë gjyqësore e pushimit të martesës së pavlefshme. Martesa e cila anulohet konsiderohet se fare nuk është lidhur. Çdo martesë e lidhur prezumohet se është e ligjshme, përkatësisht e vlefshme, derisa nuk paraqiten fakte të cilat e vërtetojnë të kundërtën, ku në këto raste martesë me vendim të gjykatës shpallet e pavlefshme, pra martesë anulohet.⁴⁹

Neni 36 i ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sa i përket kërkesës për anulimin e martesës, thotë: “Anulimin e martesës mund ta kërkojë njëri prej bashkëshortëve, prokurori publik si edhe personi fizik dhe juridik i cili për këtë ka interes juridik, nëse për këtë në ligj nuk është përcaktuar diçka tjetër. Anulimin e martesës së lidhur me dhunë mund ta kërkojë vetëm bashkëshorti i cili ka qenë i detyruar të lidh martesë. Padia mund të parashtrohet në afat prej 1 viti nga dita kur rreziku për realizimin e dhunës ka pushuar. Anulimin e martesës së lidhur nën lajthim mund ta kërkojë vetëm bashkëshorti i cili në lajthim është pajtuar të lidh martesë. Padia mund të parashtrohet në afat prej një viti nga dita kur kemi kuptuar për lajthimin.”

4. Shkurorëzimi i martesës

Shkurorëzimi është zgjidhja e një martese të vlefshme. Shkurorëzimi i martesës dallon nga anulimi pasi anulimi është zgjidhja e martesës së pavlefshme. Pra, shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e martesës së plotfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të parashikuara me ligj.⁵⁰

Shkurorëzimi i martesës mund të bëhet vetëm në qoftë se të dy bashkëshortët janë të gjallë. Në qoftë se njëri nga bashkëshortët vdes gjatë periudhës që ka qenë e iniciuar procedura

⁴⁹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 150

⁵⁰ Po aty, faqe 158

për shkurorëzim, ajo procedurë duhet të ndërpritet pasi që martesë do të pushojë me vdekjen e bashkëshortit.⁵¹

Ka raste, kur pasi të ketë filluar procedura e shkurorëzimit të martesës vdes njëri nga bashkëshortët, procedurën ka mundësi që ta vazhdojnë trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur. Në këto raste, gjykata nuk do të merr vendim për shkurorëzim, pasi siç e thamë edhe më lartë, martesë pushon me vdekje, por vetëm do të konstatohet se a ka qenë padia e bazuar.⁵²

Për shkurorëzimin e martesës kanë të drejtë të vendosin bashkëshortët bashkërisht ose vetëm njëri prej tyre me parashtrimin e kërkesës për shkurorëzim. Mirëpo, ekziston edhe ndalesa për burrin që të kërkojë shkurorëzimin nga gruaja, në periudhën kur gruaja është shtatzënë, si dhe në periudhën deri sa fëmija i posa lindur të arrijë moshën një vjeçare.⁵³

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës themelore në Tetovë, gjatë viteve 2014-2019 kjo është pasqyra e numrit të shkurorëzimeve:

Numri i lëndëve		Viti
328	Shkurorëzim i martesës	2014
330	Shkurorëzim i martesës	2015
355	Shkurorëzim i martesës	2016
357	Shkurorëzim i martesës	2017
318	Shkurorëzim i martesës	2018
349	Shkurorëzim i martesës	2019

Tabela nr.1 Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Tetovë

Nga kjo tabelë mund të vërejmë nuk kemi ndonjë rritje drastike të numrit të shkurorëzimeve të martesës. Që nga viti 2014 deri në vitin 2017, numri i rasteve të shkurorëzimit është rritur. Në

⁵¹ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 175

⁵² Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 159

⁵³ Alincic Mira, Hrabar Dubravka, Jakovac-Lozic Dijana dhe Korac Aleksandra, Obiteljsko pravo, 2006 Zagreb, faqe 82

vitin 2018 shohim ulje të numrit nga rastet e shkurorëzimit dhe përsëri në vitin 2019 numri është rritur. Nga shumica e këtyre lëndëve në Gjykatën themelore të Tetovës, shkurorëzimi i martesës është bërë me anë të marrëveshjes së bashkëshortëve.

Në Republikën e Maqedonisë, sipas të dhënave statistikore nga enti shtetëror për statistikë, gjatë periudhës së viteve 2012 – 2014 ky ka qenë numri i martesave dhe i shkurorëzimeve:

Viti	Martesa	Shkurorëzime
2012	13.991	1.926
2013	13.982	2.045
2014	13.813	2.210

Tabela nr.2 Të dhëna statistikore nga enti shtetërorë për statistikë

Nga kjo tabelë shohim që, numri i martesave është zvogëluar, ndërsa numri i shkurorëzimeve është rritur.

4.1. Sistemet juridike të shkurorëzimit

Në teori të ndryshme juridike njihen pesë sisteme juridike të shkurorëzimit: a) sistemi juridik që ndalon shkurorëzimin; b) sistemi juridik që lejon shkurorëzimin; c) sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion; d) sistemi i shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi; e) sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës.

a) Sistemi juridik që ndalon shkurorëzimin

Ky sistem ndalon shkurorëzimin e martesës nën ndikimin e filozofisë së të drejtës kanonike katolike. Kisha e trajtonte martesën si shprehje të vullnetit hyjnor prandaj nuk e lejonte shkurorëzimin e saj. Ajo lejonte vetëm institucionin e ndarjes nga shtrati dhe tryeza. Pra, kur jeta martesore bëhej e padurueshme, lejohej vetëm ndërprerja faktike e jetës së përbashkët të bashkëshortëve, mirëpo martesa ligjërisht do të vazhdonte të mbetej në fuqi. Këtë parim e përkrahte edhe e drejta kanonike shqiptare deri në miratimin e Kodit civil të vitit 1929 të Shqipërisë.⁵⁴

Ky sistem i përkiste shteteve, si: Italia, Spanja, Irlanda, Lihtenshtajni, Kili, Argjentina, Kolumbia, Brazili, etj., pasi që ishin nën ndikimin e kishës katolike. Gjithashtu, në Angli dhe SHBA shkurorëzimi nuk ka qenë i mundshëm deri vonë. Pra, në këto vende bashkëshortëve u mundësohej vetëm ndërprerja e jetës faktike, prandaj kjo ishte arsye që të krijohen bashkësitë jashtëmartesore.⁵⁵

b) Sistemi juridik që e lejon shkurorëzimin

Ky sistem e zbatohet në shtetet myslimane, aty ku zbatohet sheriat. Në këto vende e drejta e shkurorëzimit të martesës ishte e drejtë absolute dhe e pakufizuar, e cila kryesisht i përkiste burrit, ndërsa gruaja e kishte këtë të drejtë të kufizuar. Burri kishte të drejtë të martohej me më shumë gra, pra Kur'ani e lejonte poligaminë. Ky sistem është zbatuar në shtetet ku martesa ishte një çështje private, prandaj edhe për shkurorëzimin e martesës nuk kishte nevojë për ndërhyrje të organeve shtetërore. E drejta kanonike ortodokse gjithashtu

⁵⁴ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 118

⁵⁵ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 161

përkrahte këtë sistem, pra lejonte shkurorëzimin e martesës. Shkurorëzimi i martesës gjente zbatim edhe në Kodin danez.⁵⁶

c) Sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion

Ky sistem është sistemi anglo-francez i cili ka ekzistuar deri vonë, por tani thuajse nuk ekziston në asnjë vend. Ky sistem shkurorëzimin e martesës e konsideronte si dënim për bashkëshortin i cili bënte shkeljen e detyrave martesore. Këto shkelje kanë qenë të përcaktuara me ligj, si kryerja e atentatit ndaj jetës së bashkëshortit tjetër, keqtrajtimi, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, shkelja e besnikërisë martesore, etj.⁵⁷

Pra, ky sistem aplikohet në Francë dhe në vendet anglosaksone, vetëm për shkaqet e lartpërmendura. Ndërsa, për shkaqe objektive, pra kur martesa humbiste qëllimin e saj, nuk lejohej shkurorëzimi. Prandaj, legjislacioni francez dhe anglosakson hoqën dorë nga ky sistem.⁵⁸

d) Sistemi i shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi

Disa shtete të Evropës Lindore e njihnin këtë sistem, ku lejohej shkurorëzimi i martesës atëherë kur vërtetohej tronditja e thellë e marrëdhënieve bashkëshortore të cilat e bënë të pamundur vazhdimin e jetës së përbashkët, pavarësisht se cili nga bashkëshortët e kishte krijuar këtë situatë. Ky sistem shkurorëzimin e martesës e lejonte për shkaqe objektive, si p.sh. për shkak të papajtueshmërisë së karaktereve atëherë kur fajësia e bashkëshortëve as që ka ekzistuar. Pra, shkurorëzimi vinte vetvetiu si mjet shërimi.⁵⁹

Këtë sistem e përdornin ish-shtetet e socializmit realist.⁶⁰

Edhe legjislacioni i Shqipërisë e kishte këtë sistem, që nga viti 1966. Ndryshe, ky sistem quhej edhe si sistemi i shkakut të përgjithshëm (relativ) të shkurorëzimit.⁶¹

⁵⁶ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 119

⁵⁷ Po aty, faqe 119

⁵⁸ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 162

⁵⁹ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 120

⁶⁰ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 94

⁶¹ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 162

e) Sistemi i kombinuar i shkurorëzimit të martesës

Ky sistem përfshin shkaqet në të cilat mbështetet sistemi i shkurorëzimit të martesës si sanksion, si dhe ato të sistemit të shkurorëzimit të martesës si mjet shërimi.⁶²

Ky sistem, fillimisht është përhapur në Austri, Gjermani, Zvicër, Turqi, më vonë edhe në shtetet tjera. Në Kodin Zviceran si shkak i shkurorëzimit ishte shkelja e kurores, atentati kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi dhe fyerjet e rënda, lënia qëllim keqe dhe sëmundjet psikike. Pos këtyre, shkak tjetër ishte kur marrëdhëniet bashkëshortore ishin tronditur thellë dhe nuk ishte e arsyeshme që të vazhdohej bashkëjetesa, andaj njëri bashkëshort mund të parashtonte padi për shkurorëzim.⁶³

⁶²Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 120

⁶³ Aliu Abdulla, Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 162

4.2. Elementet e shkurorëzimit

Si elemente të shkurorëzimit konsiderohen: a) ekzistimi i martesës së vlefshme; b) shkurorëzimi bëhet sa të jenë të gjallë bashkëshortët; c) shkurorëzimi bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara me ligj; si dhe d) shkurorëzimi bëhet në procedurë gjyqësore.

a) Ekzistimi i martesës së vlefshme

Kjo është veçori e shkurorëzimit, pasi mund të shkurorëzohet vetëm martesa e vlefshme. Ndërsa nëse martesa nuk është e vlefshme, atëherë ajo do të anulohet. Në rastet kur ekzistojnë edhe shkaqe të anulimit edhe shkaqe të shkurorëzimit të martesës, atëherë fillimisht duhet të sqarohen shkaqet e anulimit sepse këto shkaqe kanë përparësi dhe janë më të fuqishme.⁶⁴

b) Shkurorëzimi bëhet sa të jenë të gjallë bashkëshortët

Në qoftë se vdes njëri prej bashkëshortëve atëherë do të pushojë martesa në mënyrë natyrore, prandaj nuk vjen në shprehje shkurorëzimi. Mirëpo, në praktikë ndodh që njëri bashkëshort të vdes pasi të jetë hapur procedura për shkurorëzimin e martesës. Në këtë rast martesa nuk shkurorëzohet, por vetëm mund të konstatohet se padia ka qenë e bazuar.⁶⁵

Pra, kur njëri bashkëshort vdes pasi të ketë filluar procedura e shkurorëzimit, trashëgimtarët e tij/saj, mund ta vazhdojnë procedurën për të vërtetuar themelësinë e padisë. Kështu, gjykata e zgjidhë martesën nëse ekzistojnë shkaqet ligjore për shkurorëzim, si dhe nëse martesa ka qenë e vlefshme.⁶⁶

c) Shkurorëzimi bëhet vetëm për shkaqet e parashikuara me ligj

Pasi që martesa është edhe e karakterit shoqëror, ajo nuk mund të shkurorëzohet me marrëveshje të thjeshtë, edhe pse është lidhur me vullnetin e lirë të palëve. Shkurorëzimi do të bëhet vetëm kur të ekzistojnë shkaqet e parashikuara me ligj.⁶⁷

⁶⁴ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 88

⁶⁵ Po aty, faqe 89

⁶⁶ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 121

⁶⁷ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 89

Pra, vetëm nëse marrëdhëniet martesore janë të çrregulluara apo për shkaqe tjera të parashikuara me ligj, martesa mund të shkurorëzohet. Në të kundërtën, pavarësisht nga vullneti i bashkëshortëve, ato nuk mund të shkurorëzohen.⁶⁸

d) Shkurorëzimi bëhet në procedurë gjyqësore

Martesa mund të shkurorëzohet vetëm në procedurë të rregulluar me ligj, pranë gjykatës kompetente.⁶⁹

Martesa është institucion shoqëror dhe ndodhet nën mbrojtjen e shtetit, lidhet në kushte të përcaktuara ligjore, prandaj mund të zgjidhet vetëm nga organi kompetent, pra gjykata. Gjykata do të vlerësojë nëse martesa ka humbur funksionin e saj shoqëror. Pra, dispozitat ligjore për rregullimin e martesës kanë natyrë urdhëruese dhe bashkëshortët nuk mund që këto dispozita t'i ndryshojnë me vullnetin e tyre.⁷⁰

⁶⁸ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 121

⁶⁹ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 89

⁷⁰ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 121

KAPITULLI I KATËRT

SHKAQET PËR SHKURORËZIMIN E MARTESËS

Shkaqet e shkurorëzimit janë të një numri më të madh të cilat ndërlidhen me aspektet sociologjike, juridike, historike, ekonomike, psikologjike, sociale dhe me kriza të thella shoqërore. Familja, për shkak të procesit të tranzicionit, duke u shndërruar nga një familje patriarkale në familje demokratike, shoqërohet me probleme të mëdha. Këto faktorë që ndikojnë në transformimin e familjes, njëkohësisht ndikojnë edhe në rritjen e numrit të shkurorëzimeve.⁷¹

Shkaqet e shkurorëzimit janë fakte dhe rrethana të cilat lindin pasi të jetë lidhur martesë, për shkak të së cilave mund të kërkohet shkurorëzimi i martesës.⁷²

Sipas teorive të ndryshme, shkaqe për shkurorëzimin e martesës mund të numërohen:

- a) Çrregullimi i marrëdhënieve bashkëshortore, respektivisht jeta e padurueshme në bashkësinë martesore;
- b) Tradhtia;
- c) Dhuna, fyerjet e rënda dhe sjellja e keqe;
- ç) Sëmundjet e rënda dhe paaftësia për të vepruar;
- d) Braktisja e paarsyeshme e bashkësisë martesore;
- dh) Zhdukja e njërit nga bashkëshortët;
- e) Dënimi me burgim i njërit nga bashkëshortët;
- ë) Pushimi faktik i martesës;
- f) Shkurorëzimi me marrëveshje.

a) Çrregullimi i marrëdhënieve bashkëshortore

Gjatë martesës, për shkaqe subjektive dhe objektive, krijohen shkaqe dhe rrethana prej të cilave jeta bashkëshortore bëhet e padurueshme, lindin mosmarrëveshje dhe konflikte mes bashkëshortëve. Për këtë arsye bashkësia martesore e humb qëllimin e vet, prandaj martesë mund të shkurorëzohet. Ligji nuk ka mundur t'i parashih të gjitha këto çrregullime, megjithatë vetë bashkëshorti i vlerëson këto shkaqe dhe parashtron kërkesë për shkurorëzimin e martesës,

⁷¹ Oruçi Gani, Vepër e cituar, faqe 90

⁷² Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 122

ndërsa gjykata ka për detyrë të vërtetojë këto shkaqe dhe sjell vendim për shkurorëzimin e martesës.⁷³

Neni 40 i ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë së Veriut, thotë: “Martesa mund të shkurorëzohet me kërkesën e njërit nga bashkëshortët, në qoftë se marrëdhëniet bashkëshortore janë të çrregulluara deri në atë masë sa jeta e përbashkët është bërë e padurueshme”.

Sipas të dhënave statistikore të Gjykatës themelore në Tetovë, numri më i madh i shkurorëzimeve gjatë viteve 2014-2019 është për shkak të çrregullimit të marrëdhënieve bashkëshortore.⁷⁴

Nga praktika e Gjykatës themelore në Tetovë do të shkruaj një nga rastet e shumta të shkurorëzimit për shkak të çrregullimit të marrëdhënieve bashkëshortore. Bashkëshortja L.I. për shkak të çrregullimit të marrëdhënieve bashkëshortore ka ngritur padi për shkurorëzim të martesës ndaj bashkëshortit J.Sh. Bashkëshortët kanë pasur konflikte të vazhdueshme, nuk kanë pasur gjuhë të përbashkët, sidomos sa i përket vendbanimit. Nga kjo arsye, paditësja i ka ndërpre të gjitha kontaktet me të paditurin dhe për një periudhë të gjatë nuk ka qenë në dijeni se ku ndodhet i padituri. Bashkëshortët nuk kanë pasur as pasuri të përbashkët dhe as fëmijë. Kështu, duke u shqyrtuar të gjitha faktet, gjykata ka sjellë aktgjykim për shkurorëzim të martesës.⁷⁵

b) Tradhtia

Tradhtia është një nga shkaqet më të vjetra për shkurorëzimin e martesës. Në kohët më të hershme shkak për shkurorëzim ishte vetëm tradhtia nga ana e gruas, ndërsa në ditët e sotme martesa shkurorëzohet edhe për shkak të tradhtisë nga ana e burrit. Të drejtë për të kërkuar shkurorëzim ka vetëm bashkëshorti ndaj të cilit është kryer tradhtia. Padi për shkurorëzim të martesës ka të drejtë të paraqes më së voni një vit nga momenti kur ka marrë

⁷³ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 191

⁷⁴ Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Tetovë, viti 2019.

⁷⁵ Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Tetovë, viti 2017.

vesh për tradhtinë. Pas kalimit të këtij afati, humbet e drejta e padisë dhe konsiderohet se bashkëshorti e ka falur tradhtinë.⁷⁶

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit: “Për dy punë e ka fishekun në shpinë grueja e për një punë i pritët theku e shëshohet: për kurvni; për mik të prem. Për këto dy punë të pabesijet i shoqi e vret të shoqen, e rrin pa ndore, pa besë e pa kenë i ndjekun për gjak, se prindja e grues së gjakut marrin çmimin e gjakut, e këtij do t’i napin fishekun e do ti qesin dorëzanët.” Pra, burri kishte të drejtë ta vret gruan e tij në qoftë se ajo e tradhëtonte dhe ai as nuk do të dënohej për vrasjen e gruas e as nuk do të ishte e ndjekur për gjakmarrje.⁷⁷

c) Dhuna, fyerjet e rënda dhe sjellja e keqe

Dhuna në familje, është një gjendja e dëmtimit që një anëtar i familjes e ushtron ndaj ndonjë anëtari tjetër. Kur flasim për dhunën mes bashkëshortëve, bashkëshorti ndaj të cili ushtrohet dhuna, ka të drejtë që të kërkojë nga gjykata largimin e bashkëshortit që ushtron dhunë, nga shtëpia ku jetojnë. Dhuna mund të jetë fizike, psikike ose seksuale. Dhuna nuk duhet të ndeshet asnjëherë në marrëdhëniet bashkëshortore.⁷⁸

Me fjalë të tjera, me dhunë nënkuptojmë atë kur njëri bashkëshort i shkakton lëndime trupore bashkëshortit tjetër, ose e fyen atë vazhdimisht, sidomos edhe në pjesëmarrjen e personave të tretë.⁷⁹

Fyerjet e rënda shkaktojnë vuajtje morale, prekin nderin dhe dinjitetin e bashkëshortit. Fyerjet mund të shkaktohen me fjalë fyese, me qëndrim arrogant si dhe me skandale. Ato mund të realizohen me gojë, me shkrim si dhe me sjellje. Nivelin e fyerjes e përcakton gjykata pasi t’i shqyrtojë të gjitha faktet.⁸⁰

⁷⁶ Haxhivasiliev Mile, Vepër e cituar, faqe 192

⁷⁷ Gjeçov Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999 Tiranë, faqe 20

⁷⁸ Mandro Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tafta, Fullani Arjana, E drejta familjare, 2006 Tiranë, faqe 407

⁷⁹ Haxhivasiliev Mile, Vepër e cituar, faqe 194

⁸⁰ Mandro Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tafta, Fullani Arjana, Vepër e cituar, faqe 409

Sjellja e keqe paraqitet kur bashkëshorti vazhdimisht pi alkool, harxhon pasurinë në bixhoz, si dhe me veprime të tjera jo të hijshme, të cilat e dëmtojnë edhe bashkëshortin tjetër. Pra, të gjitha këto sjellje të bashkëshorti paraqesin shkak për shkurorëzimin e martesës. Padi për shkurorëzim mund të paraqes bashkëshorti i dëmtuar. Afati për paraqitjen e padisë nuk është i kufizuar, por me faljen e bashkëshortit humbet e drejta e padisë.⁸¹

d) Sëmundjet e rënda dhe paaftësia për të vepruar

Sëmundjet e rënda paraqesin shkak për shkurorëzimin e martesës. Mund të dallojmë dy kategori për kuptimin e këtij shkak të shkurorëzimit: Së pari, bëhet fjalë për sëmundje mendore. Të tilla janë sëmundjet psikike dhe dëmtimet fizike të trurit. Këto sëmundje çojnë në dëmtimin e aftësisë për të menduar normalisht. Së dyti, kjo sëmundje duhet të jetë e pashërueshme dhe kjo duhet të vërtetohet në mënyrë zyrtare. Për vërtetimin e sëmundjes mendore shërbejnë raportet mjekësore ose vendimi i gjykatës me anë të së cilit bashkëshortit të sëmurë i hiqet zotësia për të vepruar.⁸²

Pra, sëmundjet e rënda dhe paaftësia për të vepruar paraqesin shkak që bashkëshorti mos të ketë mundësi që t'i kryejë detyrat bashkëshortore. Për këtë arsye paraqitet shkak i shkurorëzimit të martesës. Padi mund të parashtrojë vetëm bashkëshorti i shëndoshë. Që bashkëshorti i shëndoshë të ketë mundësi për të parashtuar padi, sëmundja apo paaftësia për të vepruar duhet të jenë paraqitur pasi të jetë lidhur martesa.⁸³

Sa i përket shkurorëzimit si pasojë e sëmundjeve të rënda, vlen të theksohet se për tu shkurorëzuar bashkëshortët, bashkëshorti i shëndoshë duhet të shprehë vullnetin e tij/saj për t'i dhënë fund martesës. Që do të thotë se, sëmundja mendore jo domosdoshmërisht është shkak për shkurorëzimin e martesës.⁸⁴

e) Braktisja e paarsyeshme e bashkësisë martesore

Bashkëshortët kanë për detyrë që të jetojnë bashkë. Në qoftë se njëri bashkëshort e braktis bashkëshortin tjetër pa ndonjë arsye, ekziston mundësia e shkurorëzimit të martesës.

⁸¹ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 194

⁸² Mandro Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tafta, Fullani Arjana, Vepër e cituar, faqe 411

⁸³ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 195

⁸⁴ Mandro Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tafta, Fullani Arjana, Vepër e cituar, faqe 413

Bashkëshorti tjetër ka mundësi të parashtrojë padi për shkurorëzim pasi të kenë kaluar gjashtë muaj nga dita kur bashkëshorti e ka braktisur. Braktisja paraqet shkak absolute për shkurorëzimin e martesës.⁸⁵

f) Zhdukja e njërit nga bashkëshortët

Zhdukja e bashkëshortit është rrethanë me paraqitjen e së cilës pushon martesa në mënyrë faktike. Kjo gjë paraqet shkak për shkurorëzimin e martesës. Padi për shkurorëzim mund të paraqes bashkëshorti tjetër, nëse ka kaluar një periudhë kohore e caktuar nga zhdukja e bashkëshortit. Pasi të jetë shkurorëzuar martesa, në qoftë se kthehet bashkëshorti, martesa vazhdon të ngelet e shkurorëzuar.⁸⁶

g) Dënimi me burgim i njërit nga bashkëshortët

Kur njëri bashkëshort dënohet me burgim, bashkëshorti tjetër nuk mund që të detyrohet ta presë vuajtjen e dënimit nga i dënuari. Prandaj, jetesa e tyre e përbashkët bëhet e pamundur për të dy bashkëshortët dhe martesa e humb qëllimin e saj. Për këtë arsye, mund të bëhet shkurorëzimi i martesës. Veprat penale për dënimin me burgim mund të jenë: krimet kundër jetës, veprat penale kundër shëndetit, krimet seksuale, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, etj.⁸⁷

Pra, dënimi me burgim i njërit nga bashkëshortët për kryerjen e ndonjë vepre penale, paraqet shkak absolut për shkurorëzimin e martesës. Edhe në këtë rast pushon martesa në mënyrë faktike. Të drejtë për parashttrim të padisë ka bashkëshorti tjetër.⁸⁸

h) Pushimi faktik i martesës

Shkak për shkurorëzimin e martesës paraqet edhe pushimi faktik i martesës. Pushimi faktik i martesës paraqitet në rastin kur pushon jetesa e përbashkët e bashkëshortëve, në periudhë të gjatë kohore. Të drejtë për parashttrimin e padisë kanë të dy bashkëshortët.⁸⁹

⁸⁵ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 196

⁸⁶ Po aty, faqe 197

⁸⁷ Mandro Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tafta, Fullani Arjana, Vepër e cituar, faqe 413

⁸⁸ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 198

⁸⁹ Po aty, faqe 199

Pushimin faktik të martesës e parasheh edhe ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nenin 41: “Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzimin e martesës, në qoftë se bashkësia (jeta) martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari më tepër se një vit”.

i) Shkurorëzimi me marrëveshje

Shkurorëzimi me marrëveshje nga vetë bashkëshortët ka ekzistuar që në të drejtën romake dhe zbatohet edhe në ditët e sotshme. Bashkëshortëve u lejohet shkurorëzimi dhe për këtë nuk është e nevojshme që para organeve kompetente të paraqesin arsyet se pse duan të shkurorëzohen. Por, nga bashkëshortët kërkohet që të merren vesh për mbajtjen dhe rruajtjen e fëmijëve, në qoftë se kanë fëmijë të përbashkët, si dhe për pronësinë e tyre të përbashkët.⁹⁰

Shkurorëzimin me marrëveshje e rregullon edhe ligji për familje i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nenin 39: “Martesa mund të shkurorëzohet me marrëveshje të ndërsjellë të bashkëshortëve. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, ose fëmijë madhorë të cilëve u është vazhduar e drejta prindërore, është e nevojshme që të parashtrojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave prindërore dhe për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Gjykata do të sjellë vendim për shkurorëzimin e martesës në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë të bashkëshortëve nëse vërteton se atë pajtim e kanë arritur në mënyrë të lirë, serioze dhe të pakthyeshme”.

⁹⁰ Haxhivasilev Mile, Vepër e cituar, faqe 200

1. Klasifikimi i shkaqeve të shkurorëzimit

Në teorinë juridike shkaqet e shkurorëzimit i klasifikojmë sipas disa kriterëve: a) shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta; b) shkaqet absolute dhe relative; c) shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me afat; ç) shkaqet për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit; si dhe d) shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta të shkurorëzimit të martesës.

a) Shkaqet e përgjithshme dhe të veçanta

Shkaqe e përgjithshme janë çrregullimet serioze dhe të vazhdueshme të marrëdhënieve martesore, të një shkalle të lartë aq sa vazhdimin e jetës bashkëshortore e bëjnë të pamundur. Marrëdhëniet martesore çrregullohen atëherë kur bëhet shkelja e detyrave martesore prej njërit ose prej të dy bashkëshortëve. Për shkak se në praktikë këto shkaqe përfshijnë rrethana dhe fakte mjaft të ndryshme, është e pamundur që ligjvënësi ti numëroj në mënyrë taksative, prandaj edhe quhen shkaqe të përgjithshme.

Shkaqet e veçanta janë: jeta e padurueshme bashkëshortore; shkelja e besnikërisë bashkëshortore; veprat penale kundër jetës së bashkëshortit; keqtrajtimi serioz; lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme; sëmundja psikike dhe e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar; ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit; si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme. Për t'u shkurorëzuar martesa, gjykata duhet të provojë ekzistimin e shkaqeve të lartpërmendura.⁹¹

b) Shkaqe absolute dhe relative

Shkaqet absolute kanë fuqinë e shkakut të shkurorëzimit. Që gjykata të nxjerrë vendimin për shkurorëzimin e martesës, është e mjaftueshme të vërtetohet fakti që e ka fuqinë provuese të shkakut absolut.

Shkaqet relative të shkurorëzimit të martesës në praktikë janë të shumta dhe të llojllojshme prandaj është e pamundur të numërohen në mënyrë taksative dhe të parashikohen

⁹¹ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 122

me norma ligjore. Këto shkaqe kryesisht janë të natyrës së lehtë, si dallimi në moshë, karakteret e ndryshme, xhelozia, grindjet e vazhdueshme, etj.⁹²

c) Shkaqet për të cilat fitohet e drejta e padisë pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk lidhet me afat

Ka raste kur nuk mund të parashtrohet padia para se të kalojë afati i përcaktuar me ligj. Padinë për shkurorëzim nuk mund ta parashtrojë asnjëri prej bashkëshortëve gjatë periudhës kur gruaja është shtatzëne, si dhe derisa fëmija të mbush një vit. Ky ndalim i parashtrimit të padisë bëhet me qëllim të mbrojtjes së interesave të fëmijës së mitur.

E drejta e padisë për shkurorëzim nuk është e lidhur me afat në disa raste kur ajo fitohet me lindjen e shkakut. Këto raste janë më të shumta se ato të lidhura me afat, si p.sh. shkelja e besnikërisë martesore, atentati kundër jetës së bashkëshortit, lënia qëllim keqe dhe pa arsye e bashkëshortit, etj. Kjo padi mund të paraqitet me lindjen e shkakut, ndërsa e drejta për padi nuk mund të parashkruhet me kalimin e një intervali kohor.⁹³

d) Shkaqet për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit dhe shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit

Shkaqe për shkurorëzimin e martesës për të cilat e drejta e padisë humbet pas kalimit të afatit janë të natyrës relative, në të cilat qëndron fajësia si element subjektiv. Të tilla janë lënia qëllim keqe dhe pa arsye e bashkëshortit tjetër, shkelja e besnikërisë martesore, etj.

Shkaqet për të cilat e drejta e padisë nuk humbet pas kalimit të afatit janë ato të natyrës objektive. Në këto raste e drejta e padisë nuk parashkruhet, por vetëm mund të ngrihet në çdo kohë pasi të lind shkakut për shkurorëzimin e martesës.⁹⁴

e) Shkaqet e fshehta dhe jo të fshehta të shkurorëzimit të martesës

Shkaqet e fshehta të shkurorëzimit të martesës janë ato të cilat kryhen me qëllim të shkakimit të ndonjë të keqeje ndaj bashkëshortit tjetër. Shkaqe të tilla janë si atentati kundër jetës së bashkëshortit tjetër, lënia qëllim keqe e bashkëshortit, etj.

⁹² Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 123

⁹³ Po aty, faqe 124

⁹⁴ Po aty, faqe 125

Shkaqet jo të fshehta të shkurorëzimit të martesës nuk janë si ato të fshehtat, por janë të natyrës subjektive, si p.sh. mospërputhja e karaktereve, sëmundja psikike, etj.⁹⁵

Sipas përvojës së avokatëve, numri më i madh i meshkujve shkurorëzohen nga bashkëshortet e tyre për të qenë me femra të moshës më të re. Gjithashtu arsye tjetër, sipas të dhënave statistikore është edhe pavarësia ekonomike e femrave, të cilat më lehtë marrin vendimin për shkurorëzim.

⁹⁵ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 125

2. Pasqyra historike e shkaqeve të shkurorëzimit në të drejtën romake

Sipas të drejtës romake, martesë ishte bashkim i gruas dhe burrit, një lidhje e përhjetshme dhe komunikim i të drejtës hyjnore dhe njerëzore. Gjatë epokës së të drejtës romake, martesë si institucion pësoi evolucion dhe ndryshime.⁹⁶

Fjala *matrimonium* e martesës, rrjedh pjesërisht prej fjalës *mater* – nënë. Theksi mbi amësinë sugjeron se romakët e shihnin martesën si një institucion për prodhimin e fëmijëve legjitimë. Martesë sipas të drejtës romake, nuk ishte një *sacrament* (një nocion kishtar i martesës), por një fakt social me disa pasoja të caktuara ligjore.⁹⁷

Për të lidhur martesë, sipas të drejtës romake, duhej të plotësoheshin disa kushte: palët duhej të ishin të moshës së kërkuar, palët duhej të binin dakord dhe të kishin *conubium* (të drejtë civile), si dhe martesë duhej të ishte e çliruar nga ndalesat dhe pengesat.⁹⁸

Pengesa martesore në të drejtë romake kishte disa, e njëra prej tyre ishte martesë ekzistuese. Romakët e njihnin vetëm martesën monogame. Si pengesë tjetër ishte gjinia e gjakut, në vijë të drejtë të pakufizuar, si dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt. Krushqia ishte pengesë martesore në vijë të drejtë, ndërsa gjinia civile ashtu siç ishte edhe gjinia e gjakut. Përveç këtyre pengesave, në kohën e Augustit ndalohej edhe martesë ndërmjet qytetarit të lindur në liri dhe të çliruarës me sjellje të këqija, si dhe ndalohej martesë mes senatorit dhe të çliruarve në përgjithësi. Më vonë, ndalohej edhe martesë mes tutorit dhe të miturve, mes drejtuesit të provincës dhe grave me banim në territorin e provincës, mes krishterëve dhe paganëve, mes personave që ishin betuar se nuk do të martoheshin, mes personave që e kishin shkelur kurorën si dhe martesë e ushtarëve.⁹⁹

⁹⁶ Mandro Arta, E drejta romake, 2007 Tiranë, faqe 177

⁹⁷ Borkowski Andrew, dhe Du Plessis Paul, E drejta romake, 2004 Tiranë, faqe 174

⁹⁸ Po aty, faqe 175

⁹⁹ Dhima Ken, E drejta romake, 2007 Tiranë, faqe 430

Martesa në të drejtën romake ishte e dylojshme: martesa *manus* në të cilën gruaja ishte në kontrollin ligjor të burrit, si dhe martesa e lire në të cilën gruaja nuk ishte subjekt i këtij kontrolli.¹⁰⁰

Me anë të dispozitës së tretë të tabelës IV të Ligjit të XII tabelave, ligdhënësi e rregullon çështjen e zgjidhjes së martesës së lidhur me anë të formës usus, e cila formë e legalizonte pushtetin e burrit ndaj gruas, në martesën manus. Në këtë lloj të martesës, zgjidhja e martesës bëhej në mënyrë reale të ndërprerjes së bashkësisë martesore me urdhrin e burrit, i cili e urdhëronte gruan t'i mbledhte gjërat e saja, ia merrte çelësat e shtëpisë dhe e dëbonte. Në këtë periudhë ishte i lejuar shkurorëzimi pa asnjë arsye.¹⁰¹

Pra, në të drejtën e lashtë romake, që të shkaktohej efekti juridik i shkurorëzimit, burri duhej që t'i shqiptonte fjalët solemne, respektivisht *rapidiumin* (deklarimin e njëanshëm mbi shkurorëzimin).¹⁰²

E drejta për shkurorëzimin e martesës, siç e cekëm edhe më lartë, i takon ekskluzivisht burrit dhe *pater familiasit* të burrit. Shkurorëzimi lejohej për shkak të shkeljes së kurorës, për shkak të alkoolizmit, për shkak të dështimit të fëmijës, si dhe për çdo lloj shkak tjetër që e shtynte burrin të zgjidhte martesën. Sipas "*dura lex*" gruaja nuk e kishte këtë të drejtë, sepse nuk ia lejonte pozita e saj që e kishte në familje si *alieni juris*".¹⁰³

Gjatë të drejtës së hershme, gruaja nuk mund të inicioje divorcin e martesës *manus*, por ajo mund t'i jepte fund martesës me *rapidium*. Nga fundi i Republikës, format e divorcit të martesës *manus* ishin bërë thujse të papërdorshme, kështu martesave të tilla u jepej fund njëllor si martesave të lira.¹⁰⁴

Për t'i dhënë fund martesës, nuk ishte e domosdoshme që të ketë një arsye, megjithatë shkurorëzimi nuk ishte i pëlqyeshëm. Ajo çka kërkohej ishte që të paktën njëra prej palëve të kishte përfunduar synimin për të qenë të martuar. Palët mund të divorcoheshin me miratim të

¹⁰⁰ Borkowski Andrew dhe Du Plessis Paul, Vepër e cituar, faqe 180

¹⁰¹ Halimi Musli, Marrëdhëniet juridiko- civile në Ligjin e XII tabelave, 2006 Tetovë, faqe 47

¹⁰² Po aty, faqe 47

¹⁰³ Puhani Ivo, E drejta romake, 1968 Prishtinë, faqe 189

¹⁰⁴ Borkowski Andrew dhe Du Plessis Paul, Vepër e cituar, faqe 182

përbashkët ose në mënyrë të njëanshme. *Rapidiumi* nevojitej atëherë kur vetëm njëri prej bashkëshortëve dëshironte ta përfundonte martesën.¹⁰⁵

Në periudhën post klasike divorci i njëanshëm vazhdonte të lejohej vetëm në disa raste takstative dhe të kufizuara të quajtura *divortium bona gratia*, në prani të arsyeve që konsideroheshin si të vlefshme dhe jo me faj për asnjërin nga bashkëshortët. Divorci lejohej edhe në raste tjera, për shkak të sjelljes me faj të njërit prej bashkëshortëve, si: shkelja e besnikërisë bashkëshortore apo sjellja e papranueshme e gruas, tentimi që gruaja të jetë prostitute, mbajtja e një konkubine sa i përket burrit, si dhe sa i përket të dy bashkëshortëve në rastet kur kryheshin krime të rënda si vrasja, helmimi, etj. Në raste tjera, divorci i njëanshëm konsiderohej i pavlefshëm, pra *sine causa*.¹⁰⁶

Më vonë, pësuan ndryshime edhe format e shkurorëzimit. Për shkurorëzimin e njëanshëm kërkohej që shprehja e vullnetit të bëhej me shkrim dhe të njoftohej bashkëshorti tjetër nëpërmjet *libellus repudii*, ose vullneti të shfaqej para dëshmitarëve.¹⁰⁷

Përveç vdekjes dhe divorcit, martesë zgjidhej edhe kur ndërhynte *paterfamilias* i gruas, i cili e largonte atë nga shtëpia e burrit dhe kështu ndërpritej bashkëjetesa. Kjo ndodhte në martesat e lira. Më pas, Antonio Pio e ndaloi ndërhyrjen e *paterfamilias* të gruas. Në këtë periudhë shkak tjetër i zgjidhjes së martesës ishte rënia rob e bashkëshortit nga ana e armikut. Gjithashtu, martesë zgjidhej edhe kur njëri nga bashkëshortët ishte skllav për shkaqe të ndryshme. Në kohën e Justinianit, gruaja e personit që ishte rob, duhej të priste të kalonin pesë vite për të kërkuar zgjidhjen e martesës.¹⁰⁸

Më vonë, në periudhën e krishterimit, perandorët ishin kundër divorcit, mirëpo nuk e shfuqizuan atë. E rëndësishme është se në të drejtën romake, asnjëherë nuk ka qenë primar shkak për divorc. Divorcet e paarsyeshme ishin të vlefshme por bëheshin objekte të pasojave ndëshkuese. Ndëshkimet në kohën e Justinianit për një grua ishin humbja e prikës dhe hyrja e

¹⁰⁵ Borkowski Andrew dhe Du Plessis Paul, Vepër e cituar, faqe 183

¹⁰⁶ Dhima Ken, E drejta romake, Vepër e cituar, faqe 434

¹⁰⁷ Po aty, faqe 434

¹⁰⁸ Po aty, faqe 435

detyrueshme në manastir, ndërsa për një burrë ishin humbja e një të tretës së pronave të tij si dhe hyrja e detyrueshme në manastir.¹⁰⁹

3. Pasqyra historike e shkaqeve të shkurorëzimit në të drejtën zakonore shqiptare

Martesa sipas të drejtës zakonore shqiptare ishte një marrëveshje mes familjes së djalit dhe të vajzës, në të cilën bëhej fejesa e djalit dhe vajzës, e cila krijonte gjendje të re faktike dhe juridike. Pra, me këtë marrëveshje do të plotësohej premtimi i dhënë për martesë dhe nuk kishte nevojë për marrëveshje tjetër. Bashkimi i djalit dhe vajzës me martesë e përbënte bazën e krijimit të familjes.¹¹⁰

Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit martesa do të thoshte që shtëpisë t'i shtohej një rob sa u përket punëve të shtëpisë si dhe për tu shtuar fëmijët në familje.¹¹¹ Pra, sipas Kanunit, gruaja e kishte pozitën e nënshtruar në familje, e cila i duhej familjes për të punuar, si dhe për të krijuar familje.

Sipas të drejtës zakonore shqiptare, zgjidhjen e martesës mund ta bënte vetëm burri. Sipas Kanunit të Lumës, kjo e drejtë i përkiste edhe babait të burrit, por ai detyrohej që pas zgjidhjes së martesës, t'i gjente të birit një grua tjetër. Zakonisht, vendimin për zgjidhjen e martesës, e merrnin bashkërisht burrat e shtëpisë. Në rastet kur burri kundërshtonte ato që të zgjidhte martesën, edhe ai duhej të largohej bashkë me gruan nga shtëpia. Pra, familja e lëçiste.¹¹²

Ndërsa gruaja sipas të drejtës zakonore shqiptare, nuk kishte të drejtë që të kërkonte zgjidhjen e martesës. Përrjashtim kishte vetëm në Kanunin e Lumës, ku gruaja kishte të drejtë të zgjidhte martesën për paafësitë seksuale të burrit. Në rastet tjera gruas nuk i lejohej zgjidhja e martesës. Edhe sikur burri të ketë ikur nga shtëpia, gruaja qëndronte në shtëpinë e burrit,

¹⁰⁹ Borkowski Andrew dhe Du Plessis Paul, Vepër e cituar, faqe 185

¹¹⁰ Luarasi Aleks, Studime për të drejtën zakonore shqiptare-Marrëdhëniet familjare, 2007 Tiranë, faqe 115

¹¹¹ Gjeçovi Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, 1999 Tiranë, faqe 10

¹¹² Luarasi Aleks, Studime Vepër e cituar, faqe 186

lidhte një shami në fyt në shenjë fatkeqësie. Nëse nuk kishte fëmijë, kishte të drejtë që të vendoste a do të vazhdojë të jetojë në shtëpinë e burrit apo në shtëpinë e prindërve të saj.¹¹³

E drejta zakonore shqiptare parashihte disa shkaqe për shkurorëzimin e martesës: shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vjedhja, virgjëria, si dhe shkaqe të tjera.

a) Nderi

Nderi ishte një nga parimet kryesore të së drejtës shqiptare. Shkelja më e rëndë e nderit ishte shkelja e besnikërisë bashkëshortore nga ana e gruas. Sipas kanunit të Lumës, burri e falte gjakun, por nuk e falte nderin. Prandaj, burri kishte të drejtën e shkurorëzimit të martesës në çdo rast kur ai bindej se gruaja e tij ishte e pandershme.

b) Vjedhja

Vjedhja e sendeve të huaja, si brenda familjes ashtu edhe jashtë saj, ishte shkak për shkurorëzimin e martesës. Vjedhja ishte veprim i rëndë, sidomos për gratë. Nuk ishte me rëndësi vlera e sendit të vjedhur, por veprimi nga ana e gruas.

c) Virgjëria

Gratë të cilat nuk ishin të virgjëra, ktheheshin në shtëpinë e prindërve menjëherë pas martesës dhe martesë shkurorëzohej. Mungesa e virgjërisë, shihej edhe si mungesë sinqeriteti nga ana e gruas. Shpeshherë kjo situatë shkaktonte edhe mosmarrëveshje të thella mes familjeve të dhëndrit dhe nuses.

d) Shkaqe të tjera për shkurorëzimin e martesës

Kanunet shqiptare parashikonin edhe shkaqe tjera relative për shkurorëzimin e martesës, të cilat ndryshonin nga njëra krahinë në tjetrën. Një nga këto shkaqe mund të ishte edhe steriliteti i grave. Pra, gratë që nuk lindnin fëmijë ose gratë që lindnin vetëm vajza, nuk shiheshin si gra të mira dhe për këtë arsye mund të ndaheshin. Pastaj, kishte raste kur burri mund të ndahej nga gruaja për shkak të pazotësisë së saj për të kryer punët e shtëpisë, të rriste fëmijët, kur ishte llafazane, si dhe kur ikte me ditë të tëra nga shtëpia pa lejen e burrit.¹¹⁴

¹¹³ Luarasi Aleks, Studime Vepër e cituar, faqe 201

¹¹⁴ Po aty, faqe 187

KAPITULLI I PESTË

PROCEDURA PËR SHKURORËZIMIN E MARTESËS NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

1. Objekti i procedurës për shkurorëzimin e martesës

Shkurorëzimi paraqet njërën nga mënyrat juridike të pushimit të martesës së plotfuqishme ndërmjet bashkëshortëve. Martesa do të pushojë me shkurorëzim atëherë kur aktgjykimi për shkurorëzim do të bëhet i plotfuqishëm.¹¹⁵

Martesa mund të shkurorëzohet me pajtimin e bashkëshortëve, ose me kërkesë vetëm të njërit nga bashkëshortët në rastet kur marrëdhëniet bashkëshortore janë keqësuar deri në atë masë sa që jeta bashkëshortore është bërë e padurueshme. Gjithashtu, bashkëshortët mund të kërkojnë shkurorëzimin e martesës në qoftë se bashkësia martesore ka pushuar faktikisht më tepër se një vit. Në të gjitha rastet do të zhvillohet procedurë e veçantë kontestimore e rregulluar me ligjin për familje. Objekt i procedurës për shkurorëzimin e martesës është kërkesa për shkurorëzimin e martesës.¹¹⁶

2. Parimet e procedurës së shkurorëzimit

Parimet e procedurës së shkurorëzimit janë: a) parimi i barabarësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit; b) parimi i mbrojtjes së veçantë; c) parimi i oficialitetit; ç) parimi i dispozicionit; si dhe d) parimi i përjashtimit të publikut.

a) Parimi i barabarësisë së bashkëshortëve gjatë procedurës së shkurorëzimit

Bashkëshortët janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, gjatë vazhdimit të saj si dhe gjatë zgjidhjes së saj. Ashtu që, gjatë periudhës së shkurorëzimit, asnjëri nga bashkëshortët nuk

¹¹⁵ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedural civile (Libri i parë – E drejta kontestimore), 2009 Shkup, faqe 447

¹¹⁶ Po aty, faqe 447

mund të jetë i privilegjuar. Të dy bashkëshortët nga gjykata duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë gjatë procedurës së shkurorëzimit të martesës.¹¹⁷

b) Parimi i mbrojtjes së veçantë

Me këtë parim gjykata gjatë procedurës së shkurorëzimit duhet të kujdeset për personat të cilët nuk janë në gjendje të mbrojnë të drejtat e tyre. Kujdes të veçantë gjykata duhet të ketë për interesat e fëmijëve, për personat me të meta psikike dhe për bashkëshortin e pasiguruar.¹¹⁸

c) Parimi i oficialitetit

Sipas këtij parimi, gjykata duhet t'i shqyrtojë faktet dhe provat sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) gjatë procedurës së shkurorëzimit të martesës. Gjukata duhet që t'i shqyrtojë të gjitha provat me kujdes të veçantë, me qëllim që çështja të zgjidhet në mënyrë sa më të drejtë.¹¹⁹

d) Parimi i dispozicionit

Në bazë të këtij parimi nënkuptojmë se bashkëshortët gjatë procedurës së shkurorëzimit mund të paraqesin fakte dhe prova të cilat i konsiderojnë si të domosdoshme. Pra, bashkëshortët kanë në dispozicion mundësinë e paraqitjes së fakteve dhe provave sipas vullnetit të tyre.¹²⁰

e) Parimi i përjashtimit të publikut

Kontestet martesore janë mjaft të ndërlikuara ku gjatë tyre mund të paraqiten fakte dhe prova me të cilat preken të drejtat personale të bashkëshortëve dhe personave të tjerë, të cilat janë personale dhe jo për publikun. Prandaj është paraparë mundësia e përjashtimit të publikut nga seancat gjyqësore.¹²¹

Sipas ligjit për procedurë kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publiku mund të përjashtohet plotësisht na procedura gjyqësore ose vetëm nga një pjesë e saj. Në procedurë ku është i përjashtuar publiku, me kërkesë të palëve mund të marrin pjese dy persona për të cilët vendosin palët. Pjesëmarrësit në procedurën ku përjashtohet publiku duhet

¹¹⁷ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 166

¹¹⁸ Po aty, faqe 166

¹¹⁹ Po aty, faqe 167

¹²⁰ Po aty, faqe 168

¹²¹ Po aty, faqe 168

të betohen që do të ruajnë të fshehtë të gjithë atë që ndodh gjatë zhvillimit të procedurës, pasi në të kundërtën do të kenë pasoja juridike.¹²²

3. Kompetenca vendore e gjykatës

Kompetenca vendore e gjykatës për procedurën e shkurorëzimit të martesës mund të jetë e zgjedhur ose e përzier. Pra, përveç gjykatës me kompetencë vendore të përgjithshme, gjithashtu me kompetencë vendore është edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Zgjedhjen e gjykatës në këtë rast do ta bëj paditësi.¹²³

Duhet të theksohet se në procedurën kontestimore të shkallës së parë kontestet i gjykon këshilli ose gjyqtari individual. Këshilli gjyqësor i numëron tre anëtarë, pra një gjyqtar si kryetar i këshillit dhe dy gjyqtarë porotë. Ndërsa, në shkallë të dytë gjykata gjykon çdoherë në këshill të përbërë nga tre gjyqtarë.¹²⁴

4. Inicimi i procedurës

Procedura e veçantë kontestimore për shkurorëzimin e martesës ka karakter konstitutiv dhe inicohet me padi. Nëse bashkëshortët vendosin që martesa të shkurorëzohet me pajtim reciprok, atëherë procedura për shkurorëzim do të inicohet me padi për shkurorëzimin e martesës me propozim me marrëveshje. Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, përveç marrëveshjes për shkurorëzim, duhet të parashtrojnë edhe marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore si dhe për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Në qoftë se kjo marrëveshje nuk dorëzohet së bashku me padinë me propozim me

¹²² Ligji për procedurë kontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare e RSM-së, Nr.07/2011, neni 293 dhe 294

¹²³ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 447

¹²⁴ Po aty, faqe 137

marrëveshje për shkurorëzim, atëherë gjykata do të veprojë sipas dispozitave që kanë të bëjnë me parashtrirat e parregullta.¹²⁵

E drejta e parashtrimit të padisë është e lidhur ngushtë me personalitetin e bashkëshortëve, andaj të drejtë për parashtrimin e padisë kanë vetëm bashkëshortët. Nga kjo rregull ka përjashtim vetëm në rastet kur njëri nga bashkëshortët është i sëmurë psikik apo nuk ka zotësi për të vepruar, prandaj padi mund të parashtrojë në emër të tij edhe kujdestari me pëlqimin e organit të kujdestarisë.¹²⁶

E drejta për padi nuk parashkruhet dhe nuk është e kufizuar me afate dhe kushte. Gjithashtu, e drejta në padi nuk kalon as në trashëgimtarët. Nëse njëri bashkëshort vdes gjatë zhvillimit të procedurës, atëherë martesë do të pushojë për shkak të vdekjes së bashkëshortit, ndërsa gjykata me aktvendim do ta ndërpresë procedurën për shkurorëzimin e martesës. Në këtë rast, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur i cili ka parashtruar padi për shkurorëzimin e martesës, mund të kërkojnë vërtetim se padia ka qenë e bazuar. Me paraqitjen e kësaj kërkesë procedura kontestimore nga procedurë konstitutive transformohet në procedurë deklarative.¹²⁷

Padia për shkurorëzimin e martesës mund të paraqitet edhe nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë, ku duhet të shënohet lloji i padisë dhe shkaqet për të cilat mund të parashtrohet padia. Nëse prokura nuk i përmban këto të dhëna, konsiderohet se përfaqësuesi me prokurë nuk ka prokurë të rregullt.¹²⁸

5. Kumulimi i kërkesave dhe bashkimi i procedurave

Sipas ligjit për procedurë kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në një procedurë gjyqësore paditësi ka të drejtë të paraqesë disa kërkesa kundër të paditurit atëherë

¹²⁵ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 447

¹²⁶ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 130

¹²⁷ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 448

¹²⁸ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 448

kur të gjitha kërkesat janë të njëjtën bazë faktike dhe juridike. Gjykata do të miratojë kërkesat nëse konstaton se të gjitha kërkesat janë të llojit të njëjtë të procedurës.¹²⁹

Bashkë me padinë për shkurorëzimin e martesës mund të kumulohen edhe këto kërkesa: kërkesa për ruajtje, mbajtje dhe edukim të fëmijëve; si dhe kërkesa për mbajtje të bashkëshortit. Ndërsa kontestet pasurore mes bashkëshortëve nuk mund të zgjidhen bashkë me kontestet për shkurorëzim. Gjithashtu, mund të kumulohet edhe kërkesa për anulimin e martesës. Të gjitha kërkesat të cilat mund të kumulohen me kërkesën për shkurorëzim, komulohen sipas rregullave të veçanta për komulim.¹³⁰

Në procedurën për shkurorëzimin e martesës, bashkëshorti i paditur ka të drejtë që të parashtojë padi për anulimin e martesës ose për shkurorëzimin e martesës, në gjykatë në të cilën është paditur. Kjo padi emërohet si kundërpadi dhe për të dy paditë, si për padinë ashtu edhe për kundërpadinë, gjykata do të vendosë me një aktgjykim.¹³¹

6. Kufizimi i dispozicionit të palëve

Në procedurën për shkurorëzimin e martesës, dispozicioni i palëve është i kufizuar. Palët nuk mund të ndërmarrin vendime me të cilat do të vijë deri tek ndalja e procedurës. Pra, në procedurën për shkurorëzimin e martesës është ndaluar shqiptimi i aktgjykimit për shkak të mungesës, aktgjykimi në bazë të pranimit, aktgjykimi për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadi, si dhe pajtimi gjyqësor.¹³²

Në procedurën për shkurorëzimin e martesës, paditësi ka mundësi ta tërheqë padinë. Këtë mund ta bëj pa pajtimin e të paditurit deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, ose me

¹²⁹ Ligji për procedure kontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 178

¹³⁰ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 448

¹³¹ Po aty, faqe 449

¹³² Po aty, faqe 449

pajtimin e të paditurit deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës. Ky veprim juridik arsyetohet me përpjekjet që të ruhet martesë.¹³³

Sipas ligjit për procedure kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në qoftë se paditësi e tërheq padinë dhe i padituri nuk deklarohet në afat prej 8 ditëve nga dita kur është njoftuar për tërheqjen e padisë, do të konsiderohet se ka rënë dakord për tërheqjen e padisë. Nëse padia tërhiqet, atëherë llogaritet se nuk është parashtruar aspak, si dhe ka mundësi që të parashtrohet përsëri.¹³⁴

Lidhur me dispozicionin e palëve, si specifike tjetër kemi edhe heqjen dorë nga kërkesëpadia. Paditësi deklaron se heqë dorë nga kërkesëpadia dhe kjo deklaratë ka efekt juridik të tërheqjes së padisë, që domethënë se paditësi ka mundësi përsëri të parashtrojë padi për shkurorëzimin e martesës. Nëse paditësi e tërheq padinë, gjykata do të sjell aktvendim ku do të vërtetojë se padia është tërhequr dhe me këtë rast është ndaluar procedura. Deklarata për tërheqjen e padisë i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, ndërsa gjykata e shkallës së parë do t'i kërkojë shkresat nga gjykata e shkallës së dytë dhe do të sjellë aktvendimin ku do të konstatojë se padia është tërhequr. Ndërsa, nëse deklarata i jepet gjykatës së shkallës më të lartë, ajo ia dorëzon atë gjykatës së shkallës së parë.¹³⁵

Në rastet kur procedura për shkurorëzimin e martesës është iniciuar me padinë me propozim me marrëveshje për shkurorëzim, këtë propozim bashkëshortët mund ta tërheqin deri sa procedura nuk ka mbaruar në mënyrë të plotfuqishme. Ky propozim mund të tërhiqet me parashtrësë ose procesverbal përpara gjykatës dhe gjykata do të sjell vendim për ndaljen e procedurës. Ndërsa në rastet kur procedura ka arritur deri në gjykatën e shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë me aktvendim konstaton se padia për shkurorëzim është tërhequr, e në këtë rast aktgjykimi nuk ka efekt juridik dhe procedura ndalet.¹³⁶

¹³³ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 449

¹³⁴ Ligji për procedure kontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 183

¹³⁵ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 449

¹³⁶ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 450

7. Procedura për pajtimin e bashkëshortëve

Karakteristikë në procedurë për shkurorëzimin e martesës është tentimi për pajtimin e bashkëshortëve. Kjo fazë kryhet me qëllim që bashkëshortët t'i rregullojnë raportet mes tyre dhe nëse ky tentim përfundon me sukses, rezultati do të jetë ruajtja e martesës.¹³⁷

Kjo procedurë, pra procedura për pajtimin e bashkëshortëve, nuk zbatohet nëse njëri prej bashkëshortëve është i paaftë për gjykim, nëse njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë jashtë shtetit, nëse njëri bashkëshort e ka vendbanimin e panjohur për më tepër se gjashtë muaj, si dhe nëse pas kundërpadisë për shkurorëzim të martesës tentimi për pajtim pas padisë ka përfunduar pa sukses.¹³⁸

Procedurën për pajtimin e bashkëshortëve e zbaton qendra për punë sociale ose gjykata. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, procedurën e zbaton qendra për punë sociale, ku gjykata në afat prej tetë ditësh dërgon njoftim me shkrim me të dhënat se kur është iniciuar procedura, shkaqet për iniciimin e saj si dhe të dhëna për fëmijët. Më pas, qendra për punë sociale në afat prej tre muajsh është e obliguar ta përfundojë procedurën për pajtimin e bashkëshortëve. Ndërsa, nëse bashkëshortët nuk kanë fëmijë të përbashkët, procedurën për pajtim e zbaton gjykata.¹³⁹

Sipas të dhënave statistikore nga qendra për punë sociale në Gostivar, numri i rasteve që qendra për punë sociale ka tentuar të pajtojë gjatë viteve 2014-2016 në është 225, por vetëm në 38 raste nga këto kanë pasur sukses për pajtim.

¹³⁷ Po aty, faqe 450

¹³⁸ Po aty, faqe 450

¹³⁹ Po aty, faqe 450

8. Procedura pas pajtimit të pasuksesshëm

Nëse procedura e tentimit për pajtimin e bashkëshortëve nuk ka sukses, atëherë kryetari i këshillit e cakton seancë për shqyrtimin kryesor dhe të paditurit ia dërgon padinë për shkurorëzimin e martesës.¹⁴⁰

Sipas ligjit për procedure kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pasi të pranohet padia, fillojnë përgatitjet për shqyrtimin kryesor, kryhet shqyrtimi paraprak i padisë, i dorëzohet padia të paditurit për përgjigje, mbahet seancë përgatitore, si dhe caktohet seanca kryesore. Seancën kryesore e drejton kryetari i këshillit. Gjatë përgatitjes së seancës kryesore, palët kanë të drejtë të paraqesin faktet dhe provat të cilat kanë për qëllim t'i paraqesin në shqyrtimin kryesor.¹⁴¹

Në rastet kur është iniciuar padi me propozim me marrëveshje për shkurorëzim të martesës nga bashkëshortët që nuk kanë fëmijë, kryetari i këshillit jo domosdoshmërisht duhet që të caktojë seancë për shqyrtim kryesor, por mund të bëjë vërtetimin e pajtimit reciprok të bashkëshortëve dhe të sjell aktgjykim me të cilin e shkurorëzon martesën.¹⁴²

Në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, gjykata do ta thërrasë edhe qendrën për punë sociale që të merr pjesë në seancën për shqyrtimin kryesor me qëllim që të mbrohen interesat e fëmijëve. Qendra për punë sociale duhet të japë propozim për ruajtjen, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve.¹⁴³

Bashkëshortët kanë të drejtë që të mos marrin pjesë në seancën për shqyrtimin kryesor. Ato mund të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre me prokurë. Mirëpo, për mospjesëmarrjen në seancë është parashikuar sanksion. Kështu, nëse paditësi ose përfaqësuesi i tij nuk merr pjesë në seancë, do të konsiderohet se ai e ka tërhequr padinë. Ndërsa në rastet me propozim

¹⁴⁰ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 452

¹⁴¹ Ligji për procedurë kontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 262

¹⁴² Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 452

¹⁴³ Po aty, faqe 452

me marrëveshje për shkurorëzim, nëse mungon njëri bashkëshort ose të dy dhe nuk e kanë arsyetuar mungesën e tyre, do të konsiderohet se padia është tërhequr.¹⁴⁴

Në seancën për shqyrtimin kryesor, gjykata shqyrton se a ekzistojnë shkaqet për shkurorëzimin e martesës. Gjithashtu, gjykata do të vlerësojë nëse marrëveshja për ruajtjen, mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve është në interes të fëmijëve, si dhe do të kërkojë mendim nga qendra për punë sociale, e cila në afat prej 15 ditësh pas kërkesës nga gjykata duhet të japë mendim. Pas kësaj gjykata do të sjellë vendim.¹⁴⁵

9. Parimi i shqyrtimit dhe hetimit

Në procedurën për shkurorëzimin e martesës dominon parimi i hetimit sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike, e sidomos në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët. Përfaqësimi i parimit të hetimit nuk do të thotë se gjykata është e autorizuar që të vërtetojë edhe fakte të cilat nuk i kanë paraqitur palët. Gjukata mund t'i vërtetojë ato fakte që i kanë paraqitur palët, por të cilat mes tyre nuk janë kontestuese. Gjithashtu, sipas këtij parimi, gjykata nuk guxon të hetojë faktet për të cilat ka mësuar nga deklaratat e palëve ose në ndonjë mënyrë tjetër, të cilat fakte mund të paraqesin shkak tjetër si bazë për shkurorëzimin e martesës.¹⁴⁶

Sipas ligjit për procedurë kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, provat mund të sigurohen edhe pasi vendimi të bëhet i plotfuqishëm, nëse kjo është e nevojshme pasi të jenë parashtruar mjetet juridike.¹⁴⁷

¹⁴⁴ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 452

¹⁴⁵ Po aty, faqe 452

¹⁴⁶ Po aty, faqe 453

¹⁴⁷ Ligji për procedurë kontestimore i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 257

10. Masat e përkohshme

Gjatë procedurës për shkurorëzimin e martesës mund të paraqitet nevoja për masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes së fëmijëve të përbashkët dhe besimin e tyre në ruajtje dhe edukim, si edhe për sigurim të mbajtjes së bashkëshortit. Këto masa gjykata i cakton me propozim të njëres palë ose me propozim të qendrës për punë sociale, e gjithashtu edhe sipas detyrës zyrtare. Këto masa gjykata i përcakton me aktvendim, por kundër tyre mund të paraqitet ankesa. Masat e përkohshme për mbajtje të bashkëshortit gjykata i cakton vetëm me propozim të bashkëshortit dhe në dobi të tij. Masat e përkohshme zgjasin deri në përfundimin e plotfuqishëm të procedurës për shkurorëzimin e martesës. Mirëpo gjatë procedurës, gjykata ka mundësi t'i ndryshojë masat e përkohshme me kërkesë të njëres pale ose sipas detyrës zyrtare.¹⁴⁸

11. Vendimet në procedurën për shkurorëzimin e martesës

Në procedurën për shkurorëzimin e martesës, pasi të ketë përfunduar shqyrtimi kryesor, gjykata në mënyrë meritore vendos për kërkesëpadinë, respektivisht për propozimin me marrëveshje për shkurorëzimin e martesës. Gjkata për këto kërkesa vendos me aktgjykim. Ajo mund ta refuzojë kërkesëpadinë si të pabazuar, ose ta pranojë atë dhe ta shkurorëzojë martesën.¹⁴⁹

Aktgjykimi për shkurorëzimin e martesës ka karakter konstitutiv dhe prodhon efekt juridik jo vetëm në mes palëve, por edhe *erga omnes*. Pra, martesa pushon të ekzistojë mes bashkëshortëve dhe ndaj të gjithëve. Aktgjykimi për shkurorëzimin e martesës vepron *ex nunc* që domethënë nga moment i plotfuqishmërisë dhe në të ardhmen.¹⁵⁰

Dispozitat e aktgjykimit për shkurorëzimin e martesës mund të përmbajnë vetëm një urdhër, atë se martesa shkurorëzohet, ose mund të përmbajë edhe urdhra të tjera, si: urdhrin

¹⁴⁸ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 453

¹⁴⁹ Po aty, faqe 453

¹⁵⁰ Po aty, faqe 453

për mbajtjen e fëmijëve të mitur të përbashkët dhe për besimin e tyre në ruajtje dhe edukim, ndërsa nëse martesë shkurorëzohet me propozim me marrëveshje, në urdhër shënohet marrëveshja e tyre për mbajtjen, ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve; urdhrin për mbajtjen e bashkëshortit, nëse është paraqitur kërkesë e tillë; urdhrin për ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit, nëse është paraqitur kërkesë e tillë; si dhe urdhrin për shpenzimet e procedurës.¹⁵¹

Në arsyetimin e aktgjykimit, theksohen shkaqet për shkurorëzimin e martesës. Në rastet kur martesë shkurorëzohet me propozim me marrëveshje, arsyetimi përmban vetëm konstatimin se bashkëshortët pajtimin e tyre për shkurorëzim e kanë dhënë lirisht, në mënyrë serioze dhe të paluhatshme.¹⁵²

12. Mjetet juridike

Mjetet juridike me të cilat goditet aktgjykimi në konteste të shkurorëzimit të martesës, janë të dylojshme: mjetet e zakonshme të goditjes me të cilat goditen aktgjykimet të cilat nuk e kanë marrë formën e prerë, si dhe mjetet e jashtëzakonshme të goditjes me të cilat goditen aktgjykimet të cilat e kanë marrë formën e prerë.¹⁵³

Si mjet i zakonshëm i goditjes paraqitet ankesa, ndërsa si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes paraqitet revizioni, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe propozimi për përsëritjen e procedurës.

Ankesën mund ta parashtrojë njëra nga palët. Ajo ka efekt suspenziv.

Ankesa mund të paraqitet për këto shkaqe: për shkak të shkeljeve esenciale absolute të dispozitave të procedurës kontestimore të përcaktuara me ligj; për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale; si dhe për shkak se propozimi për shkurorëzimin e martesës në bazë të pajtimit reciprok është dhënë nën lajthim, kërcënim apo dhunë dhe në rast se për dhënien e

¹⁵¹ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 453

¹⁵² Po aty, faqe 454

¹⁵³ Podvorica Hamdi, Vepër e cituar, faqe 134

këtij aktgjykimi nuk kanë ekzistuar kushte të përcaktuara me ligj. Ankesa mund të paraqitet në afat prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi është dërguar për përshkrim. Ankesa e cila nuk i përfshin shkaqet e parashikuara me ligj, do të hidhet poshtë si e palejuar.¹⁵⁴

Me mjetet e jashtëzakonshme nuk mund të goditet vendimi për shkurorëzimin e martesës nëse martesa është shkurorëzuar me aktgjykim të formës së prerë. Pra, vendimi me të cilin gjykata e ka lejuar apo refuzuar shkurorëzimin nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme vetëm në pjesën që i përket lejimit ose refuzimit. Ndërsa në pjesët tjera si: vendosja lidhur me mbajtjen e fëmijëve ose mbajtjen e bashkëshortit, mund të paraqiten mjete të jashtëzakonshme.¹⁵⁵

Aktgjykimin e plotfuqishëm për shkurorëzimin e martesës, gjykata e dërgon tek organi i administratës i cili është kompetent për udhëheqjen e librit amzë të të kurorëzuarve, më së voni në afat prej 30 ditësh, që të regjistrohen ndryshimet, si edhe tek qendra për punë sociale në rastet kur palët kanë fëmijë të përbashkët të mitur ose madhor ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindërore.¹⁵⁶

13. Pasojat e shkurorëzimit të martesës

Pasojat që dalin nga shkurorëzimi i martesës janë: gjendja statusore, mbiemri, pronësia e përbashkët, mbajtja, e drejta për trashëgim, kthimi i dhuratave, dëmshpërblimi, si dhe shpenzimet e procedurës.

a) Gjendja statusore

Me shkurorëzimin e martesës si pasojë juridike është gjendja statusore e ish-bashkëshortëve. Bashkëshortët nga statusi i personit të martuar, kalojnë në statusin e personit të shkurorëzuar. Me këtë rast, pushon martesa, si dhe ish-bashkëshortët e fitojnë të drejtën të lidhin martesë të re.¹⁵⁷

¹⁵⁴ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 454

¹⁵⁵ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 176

¹⁵⁶ Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, Vepër e cituar, faqe 454

¹⁵⁷ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 178

Neni 43 i Ligjit për familje të Republikës së Maqedonisë së Veriut thotë: “Aktgjykimin e plotfuqishëm për shkurorëzimin ose anulimin e martesës, gjykata e parashtrohet deri tek organi i administratës kompetent për mbajtjen e librit amzë të të kurorëzuarve, më së voni në afat prej 30 ditësh, me qëllim të regjistrimit të ndryshimeve, si dhe deri te Qendra për punë sociale, në qoftë se gjatë martesës kanë fëmijë të mitur ose fëmijë mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.”

Në qoftë se bashkëshorti i shkurorëzuar nga martesa e lidhur nën moshën madhore me leje të gjykatës, kërkon të lidh një martesë të re, por ende nuk e ka arritur moshën madhore, për këtë nuk ka nevojë që të kërkojë leje të re nga gjykata.¹⁵⁸

b) Mbiemri

Pas shkurorëzimit të martesës ekziston mundësia që bashkëshorti i cili e ka ndërruar mbiemrin me lidhjen e martesës, që ta mbajë mbiemrin martesor, ose ta kthejë mbiemrin të cilin e ka pasur para se të lidhë martesë. Bashkëshorti i cili e mban mbiemrin martesor edhe pas shkurorëzimit të martesës, ai ka të drejtë ta mbajë atë mbiemër edhe në qoftë se lidh martesë të re.¹⁵⁹

c) Pronësia e përbashkët

Pronësia e përbashkët e bashkëshortëve ndahet në pjesë të barabarta, përveç në rastet kur me kërkesë të njërit bashkëshort vërtetohet se të ardhurat e tij gjatë jetesës së përbashkët kanë qenë dukshëm më të mëdha se sa të bashkëshortit tjetër.¹⁶⁰

d) Mbajtja (ushqimi)

Edhe pas shkurorëzimit të martesës, vazhdon detyrimi për mbajtjen (alimentacionin) e ish-bashkëshortit, i cili nuk ka mjete për jetesë. Ish-bashkëshorti i pasiguruar ka mundësi që të paraqesë kërkesë për ushqim nga bashkëshorti tjetër në qoftë se nuk është fajtor për zgjidhjen e martesës, nëse është i paaftë për të punuar, si dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të jetuar. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë komulative.¹⁶¹

e) E drejta për trashëgim

Bashkëshortët, si pasojë e shkurorëzimit të martesës, e humbin të drejtën e trashëgimit. Gjithashtu, e drejta për trashëgim humbet edhe atëherë kur është filluar procedura për shkurorëzimin e martesës dhe bashkëshorti i cili ka paraqitur padinë për shkurorëzim vdes. Bashkëshorti i shkurorëzuar humb edhe të drejtën për trashëgimin me testament. Ekziston

¹⁵⁸ Mandro-Bilalli Arta, E drejta familjare, 2007 Tiranë, faqe 326

¹⁵⁹ Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 136

¹⁶⁰ Po aty, faqe 136

¹⁶¹ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 180

përrjashtimi në rastet kur, bashkëshorti që ka vdekur në testament ka deklaruar se edhe nëse shkurorëzohet, bashkëshorti tjetër do të jetë trashëgimtar.¹⁶²

f) Kthimi i dhuratave

Pas shkurorëzimit të martesës, dhuratat me vlerë të vogël nuk kthehen. Si problematikë shfaqet kthimi i dhuratave me vlera të mëdha, si p.sh. unazat e çmueshme, ari, vetura, banesa, etj. Kthimi i këtyre dhuratave bëhet sipas fajit të bashkëshortit. Bashkëshorti i cili nuk është fajtor për shkurorëzimin e martesës ka të drejtë t'i mbajë dhuratat si dhe ka të drejtë të kërkojë nga bashkëshorti që t'i kthehen edhe dhuratat të cilat ia ka dhënë. Në rastet kur bashkëshorti është fajtor për shkurorëzimin e martesës, nuk ka të drejtë të kërkojë kthimin e dhuratave, ndërsa ai vetë duhet t'ia kthejë dhuratat ish-bashkëshortit. Në rastet kur asnjëri nga bashkëshortët nuk është fajtor, asnjëri nuk e bën kthimin e dhuratave, ndërsa në rastet kur të dy bashkëshortët janë fajtor për shkurorëzimin e martesës, të dy kanë për detyrë t'i kthejnë dhuratat.¹⁶³

g) Dëmshpërblimi

Kur gjatë jetës së përbashkët bashkëshortët i kanë shkaktuar dëm material ose moral njëri tjetrit, si p.sh. dëmtimi i pasurisë së veçantë të bashkëshortit, dëmtimi fizik ose psikik, vjen në konsideratë dëmshpërblimi. Në këto raste gjykata do të vendosë në procedurë kontestimore, që bashkëshorti fajtor ti shpërblejë dëmin bashkëshortit të lënduar.¹⁶⁴

h) Shpenzimet në procedurë

Gjatë procedurës së shkurorëzimit të martesës, për shpenzimet gjykata do të vendosë për secilin rast veç e veç. Gjykata mund të vendosë që shpenzimet procedurale ti paguajnë të dy bashkëshortët ose njëri prej tyre kur vërtetohet se është fajtor, por në raste kur ai nuk ka mundësi të paguaj shpenzimet, gjykata ka mundësi që t'i mbulojë vetë.¹⁶⁵

Në Republikën e Shqipërisë, është parashikuar edhe mundësia e pezullimit të gjykimit me kërkesë të gruas shtatzëne. Gjykata e pezullon gjykimin e padisë për zgjidhjen e martesës, por jo më tepër se një vit nga momenti që lind fëmija. Gruaja shtatzëne duhet të paraqes prova në gjykatë (raport nga mjeku), me anë të së cilave do ta vërtetojë këtë fakt. Kjo periudhë kohore mund të ndihmojë që bashkëshortët të heqin dorë nga shkurorëzimi, pasi lindja e fëmijës mund të jetë faktorë stabilizues i marrëdhënieve mes bashkëshortëve.¹⁶⁶

¹⁶² Spiroviq-Tërpenovska Liljana, vepër e cituar, faqe 137

¹⁶³ Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, Vepër e cituar, faqe 181

¹⁶⁴ Po aty, faqe 182

¹⁶⁵ Po aty, faqe 182

¹⁶⁶ Mandro-Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta dhe Fullani Arjana, E drejta familjare, 2006 Tiranë, faqe 423

14. Pasojat e shkurorëzimit të martesës për fëmijët

Kur bashkëshortët shkurorëzohen, në qoftë se kanë fëmijë të përbashkët, duhet të vendosin se completeve a do të jetojnë fëmijët me të dy ose vetëm me njërin prej tyre, respektivisht përcaktohet se kush do ta ushtrojë të drejtën prindërore. Të dy bashkëshortët, në këtë rast prindërit, e dinë se cili është interesi më i mirë për fëmijët, si dhe e dinë se cili nga to mund t'i plotësojë këto interesa. Mirëpo, në rastet kur bashkëshortët nuk mund të arrijnë deri në një marrëveshje për fëmijët, atëherë për këtë do të vendos gjykata.¹⁶⁷

Qendra për punë Sociale gjithashtu merret me përcaktimin se cilit prind do t'i besohet në ruajtje fëmija. Sipas praktikës, në qendrën për punë sociale në Gostivar, 45% e rasteve ku prindërit janë shkurorëzuar, kanë marrë mendim nga qendra për punë sociale, se kujt duhet t'i besohet fëmija.

Sipas të dhënave nga qendra për punë sociale në Gostivar, gjatë shkurorëzimit të bashkëshortëve, në 80% të rasteve fëmijët vendosen nën kujdesin e nënës, ndërsa në 20% të rasteve, fëmijët vendosen nën kujdesit e babait.¹⁶⁸

¹⁶⁷ Draskic Marija, Porodicno pravo i prava deteta, 2007 Beograd, faqe 156

¹⁶⁸ Të dhëna statistikore nga Qendra për punë sociale Gostivar

KAPITULLI I GJASHTË

ASPEKTI KRAHASUES I PROCEDURAVE PËR SHKAQET E SHKURORËZIMIT TË MARTESËS

1. Shkaqet e shkurorëzimit në Republikën e Kosovës

1.1. Ligji për familje në Republikën e Kosovës

Edhe në Republikën e Kosovës, si në Republikën e Maqedonisë njihet institucioni i shkurorëzimit të martesës si njëra nga mënyrat e pushimit të martesës.

Në ligjin për familje në Republikën e Kosovës, neni 68 flet për shkurorëzimin e martesës: “Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mund të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. E drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë. Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër më së voni deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton besueshmërinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për shkurorëzim me marrëveshje.”

Sa i përket shkaqeve të shkurorëzimit, në Kosovë janë paraparë disa shkaqe të cilat kanë ngjashmëri me shkaqet që njihen në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë.

Si shkaqe të shkurorëzimit në ligjin për familje të Republikës së Kosovës njihen: marrëdhëniet e çrregulluara seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme mes bashkëshortëve, jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lënia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e

paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit, si dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme.¹⁶⁹

1.2. Krahasimi në mes ligjit për familje në Republikën e Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë në lidhje me shkaqet e shkurorëzimit

Në Republikën e Kosovës janë numëruar disa shkaqe për shkurorëzimin e martesës, të cilat mund t'i gjejmë edhe në ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë. Dallim mes këtyre dy ligjeve nuk gjejmë sa i përket shkaqeve të shkurorëzimit. Mund të themi se ligji për familje në Republikën e Kosovës ka përfshirë më tepër shkaqe të cilat janë numëruar në mënyrë taksative.

2. Shkaqet e shkurorëzimit në Republikën e Shqipërisë

2.1. Kodi për familje në Republikën e Shqipërisë

Ashtu si edhe në Republikën e Maqedonisë, edhe në Republikën e Shqipërisë, njihet pushimi i martesës, respektivisht mbarimi i saj.

Kodi për familje në Republikën e Shqipërisë i njuh këto mënyra të mbarimit të martesës: me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort, ose me zgjidhjen e martesës, respektivisht shkurorëzimin e martesës.

Neni 125 i Kodit për familje të Republikës së Shqipërisë, për pëlqimin reciprok të bashkëshortëve shkruan: “Kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës, i paraqesin gjykatës për miratim, së bashku me kërkesën edhe një projekt marrëveshje që rregullon pasojat e zgjidhjes së martesës. Kërkesa mund të paraqitet nga bashkëshortët ose nga përfaqësuesit e tyre respektiv.”

Neni 129 i Kodit për familje në Republikën e Shqipërisë, për shkurorëzimin e martesës për shkak të jetës së përbashkët, thotë: “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë faktikisht që prej 3 vjetësh.”

¹⁶⁹ Ligji për familje në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.32/2004, neni 69

Sa i përket shkurorëzimit kur jeta e përbashkët bëhet e padurueshme, neni 132 i Kodit për familje të Republikës së Shqipërisë thotë: “Secili nga bashkëshortët mund të kërkojë zgjidhjen e martesës kur, për shkak të grindjeve të vazhdueshme, të keqtrajtimeve, fyerjeve të rënda, shkeljes së besnikërisë bashkëshortore, sëmundjes mendore të pashërueshme, dënimit penal të rëndë të bashkëshortit ose për çdo shkak tjetër bëhet e pamundur dhe martesa ka humbur qëllimin e saj për bashkëshortin paditës ose për të dy bashkëshortët.”

2.2. Krahësimi në mes të Kodit për familje në Republikën e Shqipërisë dhe të ligjit për familje në Republikën e Maqedonisë në lidhje me shkaqet e shkurorëzimit

Edhe Kodi i familjes së Republikës së Shqipërisë ka mjaftë ngjashmëri me ligjin për familje të Republikës së Maqedonisë sa i përket shkaqeve të shkurorëzimit.

Dallimi mes Kodit dhe ligjit qëndron tek shkurorëzimi për shkak të ndërprerjes faktike të jetës së përbashkët. Në Kodin për familje të Republikës së Shqipërisë, që të vijë deri tek shkurorëzimi, jeta e përbashkët duhet të jetë ndërprerë për tre vite, ndërsa në Republikën e Maqedonisë për një vit.

KAPITULLI I SHTATË

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIME

Ashtu siç e pamë deri tani, legjislacioni i Republikës së Maqedonisë është munduar që t'i përfshijë të gjitha shkaqet e shkurorëzimit të martesës. Megjithatë çdoherë mund të ekzistojnë mangësi.

Hipotezë kryesore e punimit tim ishin shkaqet nga të cilat vjen deri tek shkurorëzimi i martesës. Ashtu siç pamë më lartë, gjatë punimit u shqyrtuan këto shkaqe. Numri më i madh i shkurorëzimeve është tek bashkëshortët e rinj, ku si shkak më i shpeshtë ashtu siç e pamë edhe nga praktika gjyqësore e Republikës së Maqedonisë, ishte çrregullimi i marrëdhënieve bashkëshortore. Në qoftë se në të kaluarën ky shkak nuk ka qenë edhe aq i shpeshtë në shkurorëzimin e martesës ngase femrat kanë qenë deri diku më të varura nga meshkujt, pra nga bashkëshortët e tyre dhe ndoshta nuk kanë pasur as përkrahjen e mjaftueshme familjare, kanë vazhduar të jetojnë në bashkësi martesore edhe pse jo të lumtura. Sot, niveli i shkollimit është rritur, femrat janë pavarësuar, andaj mendoj se kjo ndikon edhe në rritjen e numrit të shkurorëzimit.

Sa i përket hipotezës së dytë, lidhur me dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut sa i përket shkaqeve të shkurorëzimit të martesës, mendoj që gjithmonë ka hapësirë për ndryshim, apo thënë më ndryshe, për të përfshirë më tepër shkaqe, pasi me zhvillimin e shoqërisë, ndryshojnë edhe shkaqet e shkurorëzimit.

Numri i shkurorëzimeve në proporcion me numrin e martesave çdo vit rritet ende më shumë. Shkaqet për shkurorëzim ndryshojnë vazhdimisht.

Edhe pse jo i dëshirueshëm, legjislacioni i Republikës së Maqedonisë është munduar t'i përfshij të gjitha shkaqet e shkurorëzimit dhe un e shoh të arsyeshme që një çift të shkurorëzohet, sidomos në rastet kur vjen në shprehje dhuna familjare.

Është sado pak më i lehtë shkurorëzimi ku bashkëshortët nuk kanë ende fëmijë. Mirëpo, në rastet ku ekzistojnë edhe fëmijët martesorë shkurorëzimi vështirësohet. Megjithatë, ashtu siç e

thash edhe më herët në rastet ku përfshihet edhe dhuna familjare, sado e vështirë, më e mirë është si zgjidhje shkurorëzimi, pasi edhe fëmijët nuk do të rriten në një familje të shëndoshë dhe kështu do të vijë deri tek devijimi i brezave të rinj.

DEKLARATA E LEKTORES

Kjo tezë magjistrature është redaktuar dhe përmirësimet gjuhësore janë bërë nga profesoresha e gjuhës dhe letësisë shqipe Prof. Gjylsime Zenuni – Jashari dhe e konsideroj si një punim jashtëzakonisht të mirë, në të cilin përpos anës profesionale është dhënë kujdes i veçantë edhe kualitetit të shprehjeve gjuhësore, që të njëjtin e bëjnë një punim vërtetë cilësorë.

Prof.Gjylsime Zenuni - Jashari

BIBLIOGRAFIA

Tekste, monografi, artikuj

1. Aliu Abdulla dhe Gashi Haxhi, E drejta familjare, Prishtinë, 2007
2. Alinčić Mira, Hrabar Dubravka, Jakovac-Lozic Dijana i Korac Aleksandra, Obiteljsko pravo, Zagreb, 2006
3. Brestovci Faik, E drejta procedural civile II, Prishtinë, 1997
4. Borkowski Andrew & Du Plessis Paul, E drejta romake, Tiranë, 2004
5. Draskić Marija, Porodično pravo i pravo deteta, Beograd, 2007
6. Dhima Ken, E drejta romake, Tiranë, 2007
7. Gjeçovi Shtjefen, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, 1999
8. Halimi Musli, Marrëdhëniet juridiko- civile në Ligjin e XII tabelave, Tetovë, 2006
9. Хаџивасилев Миле, Семејно право, Скопје, 1987
10. Janevski Arsen dhe Zoroska-Kamilovska Tatjana, E drejta procedural civile (Libri i parë – E drejta kontestimore) Shkup, 2009
11. Luarasi Aleks, Studime për të drejtën zakonore shqiptare-Marrëdhëniet familjare, Tiranë, 2007
12. Mandro-Bilalli Arta, E drejta familjare, Tiranë, 2007
13. Mandro-Bilalli Arta, Meçaj Vjollca, Zaka Tefta dhe Fullani Arjana, E drejta familjare, Tiranë, 2006
14. Mandro Arta, E drejta romake, Tiranë, 2007
15. Oruçi Gani, E drejta familjare, Prishtinë, 1994
16. Podvorica Hamdi, E drejta familjare, Prishtinë, 2005
17. Puhan Ivo, E drejta romake, Prishtinë, 1968
18. Siljanoska Kostadinovska Cvetanka, Komentar na zakonot za semejstvoto, Skopje, 2013
19. Спировиќ-Трпеновска Љиљана, Семејно право, Скопје, 1997

Akte ligjore, kode

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008
3. Kodi i familjes, Republika e Shqipërisë, Ligji Nr.9062, 2003
4. Ligji për familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.32/2004
5. Zakon za semejstvoto, Sluzben Vesnik na R.M., Br.67/2010
6. Zakon za vonparnicna postapka, Sluzben Vesnik na R.M., Br.9/2008

Praktika gjyqësore

1. Të dhëna statistikore nga Gjykata Themelore-Tetovë
2. Të dhëna statistikore nga Qendra për punë Sociale – Gostivar